

Dokument reflektimi

SHTETI SOCIAL NË VENDET E BALLKANIT PËRËNDIMOR

SFIDA DHE MUNDËSI

Gordana Matković

SHTETI SOCIAL NË VENDET E BALLKANIT PERËNDIMOR

Përkthimi nga anglishtja:
Evis Cerga

Dokument reflektimi

SHTETI SOCIAL NË VENDET E BALLKANIT PERËNDIMOR

SFIDA DHE MUNDËSI

Gordana Matković





Parathënie

Kohezioni social në ekonomitë e vendeve të Ballkanit Perëndimor është në rrezik të vazhdueshëm. Kuadri i brishtë shoqëror dhe i mirëqenies dhe rrethanat e mbarsura me sfida ekonomike krijojnë një mjedis të destabilizuar që mund të kompromentojë dhe rrezikojë zhvillimin e qëndrueshëm në vendet e Ballkanit Perëndimor. Ekziston nevoja për fillimin e një debati dhe dialogu të gjerë, mbi baza të informuara, mbi perspektivën e shtetit social.

Disa organizata dhe hulumtues nga vendet e Ballkanit perëndimor, të cilët punojnë me aspekte të shtetit social¹ kanë nisur hartimin e një platforme rajonale për të përmirësuar komunikimin ndërmjet komunitetit të punonjësve shkencorë, hulumtuesve, shoqërisë civile dhe hartuesve të politikave në vendet e Ballkanit perëndimor në lidhje me aspektet kryesore të politikave sociale dhe shtetit social.

Ky koncept ka të bëjë me përfshirjen e hulumtuesve, politikanëve, bizneseve dhe liderëve të tjerë të shoqërisë në formëzimin e programit rajonal të shtetit social, duke kontribuar kështu në përmirësimin e dimensionit shoqëror të integritit evropian në vendet e Ballkanit perëndimor. Një nga rezultatet dhe instrumentet kryesore të influencës është fillimi dhe organizimi një aktiviteti vjetor për të diskutuar mbi perspektivën e shtetit social në vendet e Ballkanit perëndimor (i pagëzuar në mënyrë joformale si *Davosi Social i Ballkanit perëndimor*). Kjo nismë synon krijimin e vlerës së shtuar përmes influencimit të proceseve ekzistuese, të cilat nxisin një program reformash të qëndrueshme në Ballkanin Perëndimor (si p.sh. qeverisja ekonomike, Programi për reformën ekonomike dhe procesi i negociatave me BE-në, Programet e Punësimit dhe Reformës Shoqërore etj.).

Këto përpjekje janë në përputhje me [Strategjinë e Zgjerimit të BE-së për periudhën 2013-2014](#) në të cilën Komisioni Evropian thekson se "duhen bërë më shumë përpjekje për trajtimin e situatës së vështirë ekonomiko-shoqërore", ndërsa sipas vlerësimit të Strategjisë së Zgjerimit të BE-së për vitin 2015 "të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor përballen me sfida madhore strukturore ekonomiko-shoqërore, me nivele të larta

1 Gordana Matković, Qendra për politika sociale, Beograd; Elira Jorgoni, Analizë ekonomiko-sociale, Tiranë; Paul Stabs, Instituti Ekonomik, Zagreb; Aleksandar Bauca, Fakulteti i Filozofisë, Beograd; Maja Gerovska Mitev, Fakulteti i Filozofisë, Shkup; Blagica Petreski, Finance Think, Shkup; Nermin Oruč, Qendra për Zhvillim, Vlerësim dhe kërkime shkencore sociale, Sarajevë; Vesna Šučur Janjetović, Fakulteti i Shkencave Politike, Banja Luka; Ivana Vujović, Juventus, Podgoricë; Agron Demi, Instituti GAP, Prishtinë; Sabina Ymeri, Analiza ekonomiko-sociale, Tiranë dhe Žarko Šunderić, Qendra për politika sociale, Beograd.

papunësie dhe nivele të ulta të ardhurash ". Gjithashtu, në [Rezolutën e Parlamentit Evropian](#) theksohet se fuqizimi i qeverisjes ekonomike, pa një dimension social nuk mund të jetë i qendrueshëm, sikundërse kanë treguar edhe zhvillimet e fundme në BE.

Një të tillë përpjekje sjell edhe ky dokument reflektimi mbi *Perspektivën e shtetit social në vendet e Ballkanit Perëndimor*. Dokumenti i reflektimit jep një panoramë të përgjithshme përkundrejt treguesve kryesorë të shtetit social dhe merr në revistë sfidat me të cilat shteti social përballët në rang global. Në mënyrë specifike, dokumenti i reflektimit përqendrohet tek sfidat e lidhura edhe me ekonomitë e vendeve të Ballkanit Perëndimor dhe përcakton disa prej strategjive dhe varianteve kryesore për zgjidhjen e këtyre sfidave, të cilat duhen trajtuar, për të cilat duhet diskutuar dhe rënë dakord. Po ashtu, flet për hapat e mëtejshëm në lidhje me organizimin e konferencës së ardhshme dhe do të shërbejë si material për ndërtimin e avokatisë dhe partneritetit në kuadrin e kësaj nisme.

Ky studim lidhet me terminologjinë e [Parlamentit Evropian](#) në Ballkanin Perëndimor, ku përfshihen Kroacia (shtet anëtar i BE-së që nga viti 2013), Mali i Zi, Serbia, ish Republika Jugosllave e Maqedonisë (më pas do t'i referohemi si Maqedonia), Shqipëria, Bosnje- Hercegovina dhe Kosova* .

Fillesat e kësaj nisme rajonale u mbështetën nga projekti me titull [PERFORM – Performing and Responsive Social Sciences](#), një projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC), zbatuar nga Helvetas Sëiss Intercooperation dhe universiteti i Friburgut, në bashkëpunim të ngushtë me [Qendrën për Politika Sociale](#). Opinionet e shprehura në këtë studim jo detyrimisht përfaqësojnë mendimet e SDC-së apo Projektit Perform. Përfundimet, rekomandimet dhe çdo gabim i mundshëm i përkasin autorit.

Žarko Šunderić

Drejtor i Qendrës për politika sociale

Beograd

2 *Ky përcaktim nuk merr në konsideratë pozicionin në lidhje me statusin dhe është në përputhje me UNSC 1244 dhe Opinionin e ICJ për deklarimin e pavarësisë së Kosovës.



Pasqyra e Lëndës

PARATHËNIE.....7

LISTA E SHKURTIMEVE.....11

HYRJE13

SFIDAT19

1. Niveli i zhvillimit është i pamjaftueshëm për një shtet gjithëpërfshirës social?.....19
2. Situata demografike është e papërshtatshme dhe prodhon trysni afatgjata mbi shpenzimet sociale21
3. Probleme të theksuara sociale – varfëri e përhapur, papunësi e lartë dhe ndryshime të tregut të punës.....24
4. Ndryshimet në strukturën familjare – nuk janë ende alarmante, sfida qëndron tek e ardhmja e afërt.....32
5. Cilësia e arsimit dhe kujdesit shëndetësor lënë për të dëshiruar35
6. Akordimi i fondeve për sektorin social – të ulëta dhe të pamjaftueshme për të garantuar mbrojtjen sociale; probleme të dukshme në lidhje me efikasitetin në nivelin mikro.....40
7. Vlerësimi i efikasitetit dhe efektivitetit të sektorit qeveritar dhe publik është i pafavorshëm46
8. Globalizimi dhe integrimi – sfida të mëtejshme për të ardhmen e afërt48

ZGJEDHJE DHE MUNDËSI STRATEGJIKE.....51

1. Shtet i vogël social i përqendruar tek mbrojtja e të varfërve.....51
2. Përfitimet universale.....53
3. Shteti i investimit social55
4. Shtet social parandalues56
5. Përmirësimi i efikasitetit.....58
6. Aspekte të tjera që lidhen me zgjedhje dhe variante strategjike61

REFERENCAT.....63

Lista e Shkurtimeve

AL – Shqipëria
BA – Bosnje & Hercegovina
ERP – Programi i reformës ekonomike
ESSPROS – Sistemi evropian i statistikave të mbrojtjes shoqërore
BE – Bashkimi Evropian
PBB – Produkti i Brendshëm Bruto
ILO – Organizata Ndërkombëtare e Punës
FM – Fondi Monetar Ndërkombëtar
HR – Kroacia
LSMS – Anketa për matjen e standardit të jetesës
MICS – Anketa e Grupimeve të Treguesve të Shumëfishtë
ME – Mali i Zi
MK – Maqedonia
NATO – Organizata e Traktatit të Atlantikut të Veriut
OECD – Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim
PISA – Programi për vlerësimin ndërkombëtar të arritjeve të nxënësve
PPS – Standardi i fuqisë blerëse
RS – Republika e Serbisë
SILC – Anketa për të ardhurat dhe kushtet e jetesës
TFR – Përqindja totale e pjellorisë
KB – Kombet e Bashkuara
UNFPA – Fondi për Popullatën i Kombeve të Bashkuara
UNICEF – Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijët
XK* – Kosova*





Hyrje

Një rol i rëndësishëm i shtetit modern është të luajë rol në sigurimin e mbrojtjes sociale për shtetasit e vet. Aktivitetet shtetërore në sektorin social – në fushën e përfitimeve në "cash", kujdesit shëndetësor, arsimit, strehimit dhe kujdesit – zakonisht përmbledhen në termin "shtet social" (Bar, 2013, p. 10).

Ndonëse, sipas literaturës, sigurimi i nivelit bazë të mirëqenies prej kohësh konsiderohet si tipi kryesor i shtetit social (Esping-Andersen, 1990, p. 19), një përkufizim i tillë i këtij nocioni mund të jetë çorientues. Në disa segmente, si p.sh.: sigurimi i arsimit, kujdesit shëndetësor dhe të ardhurave në moshë të thyer përmes sigurimeve shoqërore publike, ka disa shembuj të vendeve të zhvilluara ku fokusi i shtetit social mund të jepet përmes përcaktuesve të tillë si "minimal/e" dhe "bazë".

Objektivat e shtetit social ku përfshihet si efikasiteti ashtu edhe barazia janë të shumfishta dhe përfshijnë: uljen e varfërisë, uljen e pabarazisë, barazinë (sheshimin) e konsumit dhe mbrojtjen nga risqe të tilla si: papunësia, aftësia e kufizuar dhe sëmundjet (Briggs, 1961, p. 226), (Bar, 2013). Aktivitetet e shtetit social nuk kanë si synim vetëm grupet e pjesës së varfër dhe vulnerabël të popullatës, por edhe gjerësisht tërë popullatën në përgjithësi. Objektivat specifike dhe grupeve të synuara u është dhënë diku rëndësi më e madhe, diku më e vogël, në dizenjon e përgjithshme të shteteve të ndryshme sociale (Esping-Andersen, 1990).

Për përmbushjen e objektivat të lartpërmendura, shumica e shteteve moderne sigurojnë asistencë sociale dhe strehim social për të varfërit, pensione, pagesa universale për fëmijët, arsim dhe kujdes shëndetësor "falas"³; garantojnë politika aktive të tregut të punës; përfitime për papunësinë, përfitime për paaftësinë, për sëmundje, lejelindjeje; dhe sigurojnë ose financojnë shërbime të ndryshme të kujdesit social për të moshuarit e pamundur, fëmijët e privuar nga kujdesi prindëror dhe personat me aftësi të kufizuar. Përveç financimit të përfitimeve sociale dhe shpesh ofrimit të shërbimeve publike, shteti ka një rol të rëndësishëm në sferën e regullimit (miratimit të legjislacionit, licensimit të ofruesëve të shërbimeve, mbikëqyrjes dhe monitorimit). Kufijtë e shtetit social nuk janë të "prerë me thikë"; rrjedhimisht, sipas disa hulumtuesve, në aktivitetet e shtetit përfshihen politika që ndikojnë kapacitetet e të ardhurave, pagën minimale dhe strukturën e tregut të punës (Esping-Andersen & Myles, 2011). Të përkufizuara

3 Falas në pikën hyrëse

në këtë mënyrë, aktivitetet e shtetit social përfshijnë gjithashtu politika që përcaktojnë pagat dhe punësimin, si burim i mirëqenies individuale.

Të tilla përpjekje rezultojnë në një përqindje të lartë të shpenzimeve publike për mbrojtjen sociale⁴ dhe arsimin, duke shkuar, mesatarisht tek mbi një e treta e PBB-së në vendet e Bashkimit Evropian⁵. Për më tepër, ka autorë që e përkufizojnë shtetin social në terma që lidhen me nivelin e shpenzimeve në sektorin social. Kështu, sipas Therborn-it, shtete sociale janë ato shtete ku më shumë se gjysma e shpenzimeve shtetërore përdoren për këtë qëllim (Gough, 2008, p. 40), ndërsa sipas Lindert-it (2016, p. 4), ndonëse pa përpjekje për një përgjithësim, shtetet sociale janë ato shtete ku shpenzimet për transfertat sociale (dmth pa përfshirë shpenzimet për arsimin) i tejkalojnë 20% të PBB-së.

Aspektet e hulumtimit, si edhe dilemat ideologjike dhe etike që lidhen me shtetin social janë të shumta.

Ndër dilemat kryesore hyn edhe çështja nëse dhe deri në sa duhet të jetë përqindja e arsimit, mbrojtjes dhe sigurisë që ofrohet nga institucionet shtetërore dhe sociale. Kjo konsiderohet *par excellence* një çështje ideologjike që lidhet me besimet e përgjithshme mbi përfshirjen e tepruar apo të pakët të shtetit (p.sh. libertarianët përkundrejt socialdemokratëve). Deri në shkallën që teoritë e dështimit të tregjeve në sektorin social janë të pranueshme⁶, kjo dilemë, së paku pjesërisht shndërrohet në një çështje teknike dhe zgjidhja e saj në përgjithësi rrotullohet rreth diskursit ideologjik dhe objektivat përkatëse të përcaktuara nga një shoqëri, duke përfshirë edhe sferën e barazisë (Stiglitz, 2013), (Bar, 2013).

Në kushtetutat e tyre, shumë vende evropiane evidentohen si shtete sociale qoftë shprehimisht (Gjermania, Franca, Spanja, Sllovenia, Kroacia), ose në mënyrë implicite, përmes përshkrimit të hollësishëm të përgjegjësisë të shtetit në sektorin social në

4 Me përjashtim të rasteve të shprehura në mënyrë specifike, në të gjithë tekstin termi "mbrojtja sociale" përdoret në kuptim të gjerë si mbrojtja nga risqet dhe nevojat që lidhen me: papunësinë, përgjegjësitë prindërore, sëmundjet dhe kujdesin shëndetësor, invaliditetin, humbjen e një bashkëshorti, moshën e vjetër, strehimin dhe përjashtim social. Ky përkufizim është në përputhje me metodologjinë ESSPROS.

5 Në vitin 2013, shpenzimet për mbrojtjen sociale në vendet e BE (28) ishin në nivelin 28.9% të PBB (Baza e të dhënave e Eurostatit, Tabelat: *Shpenzimet për mbrojtjen sociale: rezultatet kryesore*) ndërsa ato për arsimin tek 5.3% (Baza e të dhënave e Eurostatit, Tabelat: *Shpenzimet në total për arsimin sipas nivelit arsimor dhe orientimit programor – si % e PBB*).

6 Dështime të tregut, të tilla si: probleme të konkurrencës, efekte të jashtme, mallrat publike, informacion asimetrik (fenomeni i rrezikut moral dhe përzgjedhjes negative) dhe probleme me informacionin janë argumente në favor të formave të ndryshme të ndërhyrjes së shtetit në sektorin social.



kuadrin e të drejtave sociale (si p.sh. Suedia⁷). Kështu, përmes instrumenteve supreme juridike, këto shtete kanë zgjedhur t'i japin shtetit social⁸ rolin më të lartë në rendin e tyre social.

Sigurisht, një çështje thelbësore mbetet nëse shteti social ngadalëson zhvillimin ekonomik. Ndonëse, deri më tani nuk ka pasur fake empirike përfundimtare apo të pakundërshtueshme që kanë konfirmuar pasojat negative ekonomike të ndërhyrjes së shtetit në sferën shoqërore (Lindert, 2016, p. 5) (Garfinkel & Smeeding, 2010), përpjekjet për ta paraqitur shtetin social dhe politikatat sociale si faktorë produktivë me ndikim pozitiv në zhvillimin dhe rritjen ekonomike kanë qenë të dukshme, në vecanti që nga miratimi i Strategjisë së Lisbonës⁹. Paradigma e investimit social, e cila i vlerëson investimet specifike në sektorin social si produktive është formuluar dhe promovuar në të njëjtën frymë. Investime shoqërore konsiderohen investimet në sektorë të tillë si: arsimi dhe kujdesi shëndetësor, si edhe programet e trajnimit, rehabilitimit, kujdesit për fëmijët dhe punësimin. Këto janë ndërhyrjet që përbëjnë investime në kapitalin njerëzor dhe nxisin punësimin, dhe politikatat aktive dhe parandaluese¹⁰. Sipas disa autorëve, vëmendja e shtuar ndaj investimeve sociale shënon një fazë të tretë të dallueshme në zhvillimin e shtetit social (pas fazës universale dhe neo-liberale)¹¹ (Hemerijck, 2012).

Një aspekt me rëndësi të posaçme në këtë kuadër është perspektiva e shtetit social. Kriza e parë e tregut të naftës në vitin 1973 shënoi fundin e epokës së artë të shtetit social¹² dhe fillimin e një debati që zgjati disa dekada në lidhje me krizën e tij, i cili vazhdon edhe sot e kësaj dite. Akademikët botuan libra në të cilët terma si: "kriza", "mirëqenia ekonomike" dhe "fundi i shtetit social" apo "çfarë vjen pas shtetit social" ose "gara drejt fundit" gjendeshin në kombinime të ndryshme" (Glennerster, 2007, p. 2).

7 Neni 2 i Kushtetutës së Suedisë specifikon se institucionet publike duhet të garantojnë të drejtën për shëndet, punësim, strehim dhe arsim. (Kapitulli 1, Neni 2) <http://www.parliament.am/library/sahmanadrutyunner/Sweden.pdf>

8 Disa autorë bëjnë një dallim të rëndësishëm midis shtetit social dhe shtetit të shërbimit social (Briggs, 1961, p. 10), ndonëse terma të tjera i atribuohen pjesërisht arsyeve historike dhe traditave të ndryshme gjuhësore (p.sh në anglisht: *Welfare state* dhe në gjermanisht *Sozialstaat*).

9 Welfare e politikave sociale (2000-2005) https://www.ucc.ie/archive/hdsp/Social_Policy_Agenda_com379_en.pdf; <http://ec.europa.eu/social/main.jsp?catId=1044&langId=en&newsId=1807&moreDocuments=yes&tableName=news>

10 <http://ec.europa.eu/social/main.jsp?catId=1044&langId=en>

11 Sipas Hemerijck, faza e parë është faza e përfitimeve universale sociale, e frymëzuar nga ekonomiksi keynesian dhe sigurimet shoqërore të Beveridge-it, ndërsa faza e dytë është era neo-liberale e de-regullimeve, privatizimit dhe shkurtimeve në shpenzime buxhetore nga ana e shtetit social.

12 Periudha midis viteve 1950 - 1973 njihet gjithashtu si edhe epoka e artë e zhvillimit ekonomik.

Kolapsi dhe rënia e shtetit social nuk ndodhën (Castles, 2004) (Glennester, 2007) (Bar, 2013). Megjithatë, ndryshimet janë të vazhdueshme dhe përfshijnë:

- Politika sociale aktive përkundrejt atyre pasive – politikat sociale aktive duhet të ndihmojnë në kapërcimin e problemit të rrezikut moral¹³ dhe në vend të financimeve pasive të përfitimeve në para (*cash*) kërkon pjesëmarrjen aktive të përfituesit (disa nga masat përfshijnë trajnime dhe ritrajnime, programe të eksperiencës në punë, politika puna paguan¹⁴, programe mirëqenieje në punë, punësim i subvencionuar, etj.;
- Futja e mekanizmave të tregut dhe konkurrencës në sferën e ofrimit të shërbimeve – shteti tërhiqet nga roli i ofrimit të shërbimeve, duke vazhduar të mbajë rolin e financimit, ose duke dhënë tollona, ose duke nënkontraktuar ofrues privatë shërbimesh;
- Tkurrja e fondeve publike për sektorin social– inkurajimi i sigurimeve private dhe sigurimeve shëndetësore suplementare, duke ia kaluar një pjesë më të lartë të kostove klientëve (rritja e nivelit të bashkëpagesave në sektorin e kujdesit shëndetësor dhe atij social, tavan mbulimi nga sigurimet publike), duke kaluar një pjesë të kostove tek punëdhënësit në sektorin privat (pagesat në rast sëmundjeje, kujdes për fëmijët etj.), financimi i arsimit të lartë nga burime private etj.;
- Përmirësimi i efikasitetit përmes ruajtjes/përmbajtjes së kostove dhe uljes së shpenzimeve në sistemet publike– duke e kaluar theksin nga përfitimet universale tek përfitimet sipas testit të pasurisë; ndryshime në sistemin publik të pensioneve (duke rritur vitet që kërkohen për vjetërsi pune dhe moshën e daljes në pension; barazimi i kërkesave për daljen në pension për burrat dhe për grate; forcimi i kërkesave për përfitim nga aftësia e kufizuar, përfitimet e parakohshme, ndryshime në indeksimin e pensionit), ndryshime në modelet e financimit të shëndetit dhe arsimit publik me qëllim rritjen e efikasitetit (për frymë, grupet sipas diagnozave);
- Rritja e efikasitetit përmes përmirësimit të cilësisë së shërbimit (si p.sh. ndryshime në përmbajtjen dhe programet lëndore në arsim, kualifikim i vazhdueshëm profe-

13 Në rastin e asistencës sociale, rreziku moral qëndron në faktin që aplikantët dhe familjarët e tyre do të "mbahen" tek ndihma ekonomike, në vend që të kërkojnë të përmirësojnë gjendjen e tyre (OECD, 1998, p.78)

14 Politikat e punës që paguan funksionojnë ose nëpërmes anës së ofertës (duke rritur të ardhurat e disponueshme të punëmarrësve me fitime të ulta në terma absolutë dhe/ose krahasur më të ardhurat nga përfitimet sociale); ose ana e kërkesës (duke ulur kostot jopaga të punëdhënëseve me punëmarrës me roggë të ulët)" (Group of Experts on Making Work Pay, 2003, p.8)

sional për arsimtarët, përmirësimi i standardeve minimale, hartimi i protokolleve të ndryshme për bashkëpunimin ndërsektorial etj.).

Reformat në vazhdë që po zbatohen në sektorin social perceptohen nga disa humltues si dëshmi e qëndresës (Castles, 2004) (Glennester, 2007) (Morel, Palier, & Palme, 2012), ndërsa të tjerë sjellin argumentin se shteti social praktikisht ka ndryshuar në mënyrë thelbësore dhe është transformuar në shtetin mundësues (enabling state) (Gilbert, 2002) (Gilbert & Terell, 2010) apo në shtetin e punës (workfare state) (Jessop, 1993) (Jessop, 1999).

Sfidat e financave publike dhe trysnitë që kërkuar ndërmarrjen e reformave në të kaluarën janë po kaq të vërteta edhe për të ardhmen e shtetit social. Ndër më kryesoret në literaturë përmenden: globalizmi, proceset e integritit, ndryshimet demografike dhe në veçanti plakja e popullatës, rritjet e pritshmërive të konsumatorit, ndryshimet në strukturën e familjes dhe ndryshimet në tregun e punës (Castles, 2004) (Glennester, 2007) (Gilbert & Terell, 2010) (Bar, 2013). Ndër ndryshimet e reja të rëndësishme përfshihen: pabarazia, sidomos pabarazia globale mes individëve, dhe migrimi, duke përfshirë edhe refugjatët (Milanović, 2012) (Hemerijck, 2012a) (Glennester, 2007).





Sfidat

Nëse ruajtja e standardit minimal bazë do të konsiderohet si tipari qendror i shtetit social, atëherë është thuajse e pamundur të vlerësohet nëse vendet e Ballkanit Perëndimor aktualisht e kanë një të tillë shtet social, apo nëse ato po përpriqen ta ndërtojnë apo reformojnë atë, apo nëse e kanë pasur dhe e kanë humbur gjatë përpjekjeve për reforma. Nga këndvështrimi i diskutimit të varianteve dhe strategjive që do të shohim në vijim del se është më e rëndësishme (dhe më e drejtpërdrejtë) të përcaktohen sfidat specifike që lidhen me veprimtaritë shtetërore në sektorin social në këtë rajon.

Pjesa më e madhe e sfidave të evidentuara në një pjesë të madhe të vendeve të zhvilluara janë gjithashtu të pranishme në vendet e Ballkanit Perëndimor, kryesisht në një formë edhe më akute, si pasojë e mungesës së fondeve, problemeve mbizotëruese sociale, kapaciteteve të dobta dhe mungesës së përgjithshme të efikasitetit qeverisës dhe atij të sektorit publik. Reformat pengohen dhe sfidat thellohen si rezultat i klientelizmit të përhapur, trashëgimisë së shtetit "socialist" social të Bismarkut dhe politikave kufizuese të financave publike, në veçanti gjatë dhe menjëherë pas krizës globale financiare.

1. Niveli i zhvillimit është i pamjaftueshëm për një shtet gjithëpërfshirës social?

Sipas standardeve evropiane, niveli i zhvillimit i vendeve të Ballkanit Perëndimor është i ulët. Në vitin 2014, PBB-ja për frymë e shprehur sipas standardit të fuqisë blerëse¹⁵ ishte në gamën nga 7,800 në Shqipëri dhe Bosnjë – Hercegovinë dhe 10,600 në Malin e Zi. Vetëm Kroacia, me një PBB për frymë shumë më të lartë, që e tejkalonte 16,000 PPS dilte jashtë kësaj game.

Në krahasim me mesataren e vendeve të EU (28), raporti i PBB-së për frymë varionte midis 28 dhe 37 përqind në pjesën më të madhe të vendeve. Vlera disi më të larta janë regjistruar në Malin e Zi (42%) dhe në vendin më të zhvilluar në rajon – Kroaci (59%), i vetmi vend produkti i brendshëm bruto për frymë e të cilit kalon gjysmën e mesatares së EU (28).

15 Standardi i fuqisë blerëse (PPS) është një monedhë artificiale (e përbashkët). Në teori, një PPS mund të shërbejë për të blerë të njëjtën sasi mallrash dhe shërbimesh në çdo vend. [http://ec.europa.eu/eurostat/statistics-explained/index.php/Glossary:Purchasing_power_standard_\(PPS\)](http://ec.europa.eu/eurostat/statistics-explained/index.php/Glossary:Purchasing_power_standard_(PPS))



Në kontekstin e niveleve kaq të ulëta të PBB-së, një rrethanë tjetër tepër negative ka të bëjë me faktin që disa prej vendeve të Ballkanit Perëndimor, si: Mali i Zi, Serbia, Kroacia dhe Shqipëria përballen gjithashtu me nivele të larta të deficitit buxhetor (mbi nivelet e përcaktuara nga Mastrohti) dhe nivele të larta borxhi (raporti i borxhit publik përkundrejt PBB e tejkalon 60%)¹⁶. Në vitin 2015, vetëm në Kosovë u regjistrua një nivel tepër i ulët borxhi (12.9% e PBB), pjesërisht për shkak të aksesit shumë të kufizuar në tregjet financiare ndërkombëtare.

Tabela 1: PBB për frymë në vendet e Ballkanit Perëndimor, viti 2014

Vendi	AL	BA	HR	XK*	ME	MK	RS
Indicator							
PBB për frymë (€)	3,440	3641	10,200	2,935 ¹	5,436	4,127	4,635
PBB për frymë, PPS	7,800	7,800	16,100	-	10,600	10,000	9,500
PBB për frymë, PPS (EU = 100)	30	28	59	-	42	36	37

Burimi: baza e të dhënave e Eurostat-it, Kroacia –Tabelat agregatë kryesore të PBB për frymë, vende të tjera –Tabelat vendet candidate dhe candidate potenciale: PBB dhe agregatë kryesore; PBB për frymë në PPS (EU 28 = 100) – Tabela PBB për frymë në PPS

Shënim: ¹ 2013

Në terma globale, sipas metodikës së Bankës Botërore, vendet e Ballkanit Perëndimor hyjnë në grupin e vendeve me të ardhura të mesme të larta, me përjashtim të Kroacisë (me të ardhura të larta) dhe Kosovës (të ardhura të mesme të ulëta)¹⁷.

¹⁶ Tabelat e Eurostat-it Shtetet candidate dhe candidate potenciale: Statistika qeveritare dhe deficit/suficiti/borxhi dhe të dhëna të tjera, me përjashtim të deficitit qeveritar të Malit të Zi (Centralna banka Crne Gore, 2016)

¹⁷ <https://datahelpdesk.worldbank.org/knowledge/articles/906519>



2. Situata demografike është e papërshtatshme dhe prodhon trysni afatgjata mbi shpenzimet sociale

Situata demografike është e disfavorshme në pjesën më të madhe të vendeve të Ballkanit Perëndimor. Tiparet negative demografike kryesisht përfshijnë:

- Përqindjet e ulëta totale të pjellorisë, në veçanti në Serbi dhe Kroaci (1.46 dhe 1.4), nën nivelin e zëvendësimit. Vetëm Kosova e tejkalon këtë nivel (2.2).
- Rritje natyrore negative konstatohet në Serbi, Kroaci dhe Bosnje- Hercegovinë; në dy të parat, fenomeni ka vijuar për më shumë se dy dekada e gjysmë. Në Shqipëri dhe Kosovë, ndonëse në nivele të larta, rritja natyrore ka kontribuar në shtimin e popullatës në një shkallë më të ulët se migrimi.

Përqindje negative ose zero të migrimit në të gjitha vendet, në veçanti në Shqipëri dhe Kosovë. Sipas të dhënave të Eurostat-it, për tre vjet (2012 – 2014), afërsisht 50 mijë persona emigruan nga Kroacia, 74 mijë nga Kosova dhe 150 mijë nga Shqipëria¹⁸. Gjatë dy dekadave të fundit, një numër prej 4.9 milionë personash, dmth afërsisht 25% e popullatës është larguar nga rajoni (me përjashtim të Kroacisë) (Svetska banka, 2015, p. 21).

Si rezultat i rritjes natyrore ose migrimit dhe të dy këtyre faktorëve bashkë, popullsia e vendeve të Ballkanit Perëndimor është tkurrur dhe plakur. Gjatë viteve të fundit, vetëm Mali i Zi dhe Maqedonia kanë regjistruar nivele të ulëta pozitive të rritjes së popullatës.

Plakja e popullatës është vecanërisht e theksuar në Serbi dhe Kroaci, ku përqindja e popullatës së moshuar mbi 65 vjeç e kalon 18.5% dhe është afër mesatares për vendet e BE-së (28). Faktorët kryesorë që influencojnë në plakjen e popullsisë janë niveli i ulët i pjellorisë dhe rritja e pritshmërisë jetike, por në disa shtete të Ballkanit Perëndimor, fluksi i emigracionit ka luajtur gjithashtu rolin e tij. Në rang evropian, rritja më e lartë në moshën mesatare gjatë dhjetë viteve të fundit është shënuar në Shqipëri¹⁹. Popullata e Kosovës është ende e re, dhe fëmijët e moshës nën 15 vjeç përfaqësojnë mbi 28% të popullatës, ndërsa përqindja e personave të moshuar është shumë e ulët (vetëm 6.8%).

18 Baza e të dhënave e Eurostat-it për Kroacinë: *Tabelat Emigracioni sipas moshës dhe gjinisë*, për Kosovën dhe Shqipërinë: *Tabelat: Shtetet kandidate dhe kandidate potenciale: popullsia – demografia*

19 http://ec.europa.eu/eurostat/statistics-explained/index.php/Population_structure_and_ageing

Tabela 2. Karakteristika të përzgjedhura demografike, Ballkani Perëndimor, viti 2015

Shteti	AL	BA	HR	XK*	ME	MK	RS
Treguesi							
Numri i përafërt i popullsisë	2,892,302	3,819,486	4,225,316	1,772,107	622,099	2,069,172	7,114,393
Përqindja e rritjes natyrore (‰)	3.7	-1.5 ¹	-4.0	12.4	1.7	1.3	-5.4
Migrimi neto plus korrektime (‰)	-5.9	0.0 ¹	-4.3	-31.1	-1.5	-0.2	0.0
Përqindja total e pjellorisë	1.67	1.24	1.40	2.2 ¹	1.74	1.50	1.46
Përqindja e popullsisë së moshuar (65+) (%)	12.4	15.8 ¹	18.8	6.8 ¹	13.7	12.7	18.5

Burimi: Numri i popullsisë– baza e të dhënave e Eurostat-it, Tabelat vendet candidate dhe candidate potenciale: popullsia – demografia, Kroacia Popullsia me 1 janar, sipas moshës dhe gjinisë; përqindja e rritjes natyrore dhe e e migrimit – Baza e të dhënave e Eurostatit, ndryshimet e popullsisë; TFR – Eurostat, Tabela Përqindja totale e pjellorisë Treguesit e pjellorisë, Kosova – Tabelat vendet candidate dhe candidate potenciale: popullsia – demografia, B&H – (Agencia za statistiku Bosne i Hercegovine, 2016); Përqindja e të moshuarve – Baza e të dhënave e Eurostatit, Tabela Popullsia: treguesit strukturorë, me përjashtim të B&H dhe Kosovës – Tabelat Vendet candidate dhe candidate potenciale: popullsia – demografia

Shënim: ¹ 2014

Sfidat demografike "përkth ehen" në sfida të shtetit social përmes kanaleve të shumëfishta.

Së pari, plakja e popullsisë, në veçanti duke pasur parasysh përqindjen në rritje të të moshuarve të grupmoshës mbi 80 vjeç krijon tryzni të larta mbi sistemin e pensione dhe kujdesin shëndetësor dhe rrit nevojat e kujdesit afatgjatë. Rrjedhimisht, plakja e popullsisë ka impaktin më të lartë pikërisht në ato segmente të shtetit social që janë më të kushtueshmet dhe më prevalentet në shpenzimet e sektorit social. Nga ana tjetër, proceset demografike sjellin si pasojë rënien e krahut të punës dhe rritjen e raportit të varësisë së moshës, çka jo vetëm ka ndikim në performancën ekonomike



të një shoqërie, por nga ana tjetër ul potencialin për financimin e sigurimeve shoqërore, të cilat varen ndjeshëm nga taksat mbi punën. Në periudhën afatgjatë, plakja e krahut të punës, si pjesë e fenomenit të plakjes të popullsisë, si edhe e përpjekjeve për trajtimin e pasojave të tij, kërkon rritjen e fondeve për trajnime dhe ritrajnime, si edhe për përfitimet e papunësisë dhe aftësisë së kufizuar, për shkak të një pjesëmarrjeje më të zgjatur në krahun e punës të të moshuarëve.

Së dyti, si pasojë e nivelit të përgjithshëm të ulët të pjellorisë, shtetet e Ballkanit Perëndimor po u bashkohen radhëve të atyre rajoneve të cilat nuk mund të varen nga migrimi apo nga rritja e nivelit të veprimtarive ekonomike për të kapërcyer çështjen e shpenzimeve publike sociale në rritje si pasojë e moshimit, as në të ardhmen (Castles, 2003, p. 210). Për më tepër, përqindjet e ulta të pjellorisë kërkojnë përpjekje për formulimin dhe zbatimin e masave të politikave, të cilat mund të "hanë" një përqindje të mirë të buxhetit të sektorit social, me rezultate të pasigurta dhe potencialisht edhe me ndikimin negativ mbi objektiva të tjera të rëndësishme, si p.sh.: arsimi, zhvillimi i fëmijërisë së hershme apo rritja e aktivitetit ekonomik të grave²⁰. Kjo kryesisht ka të bëjë me masa si për shembull sigurimi i përfitimeve të larta mujore gjatë periudhave të gjata kohore për gratë që kanë lindur fëmijën e tretë (Maqedonia dhe Mali i Zi). Nga ana tjetër, përqindje të tilla të ulta pjellorisë mund të nxisin hartimin e një politike gjithëpërfshirëse për mbështetjen e familjeve, si, fjala vjen, zhvillimi i shtetit social në Suedinë e para Luftës së Dytë Botërore, i frymëzuar nga problemi i popullsisë (Morel, Palier, & Palme, 2012, p. 3). Çështja e niveleve të ulta të riprodhimit dhe plakja e popullsisë theksohen edhe nga Lordi Beveridge në raportin e tij që frymëzoi krijimin e shtetit social në Mbretërinë e Bashkuar. Në kuadrin e situatës demografike të pasluftës, ai theksoi se ishte e domosdoshme t'u jepej përparësi shpenzimeve sociale për kujdesin në fëmijëri dhe mëmësi (Beveridge, 1942, p. 8).

Bilanci negativ i migrimit dhe emigrimit kontribuon gjithashtu në plakjen e popullatës, duke pasur parasysh natyrën selektive të migrimit dhe faktin që emigrantët janë kryesisht të rinj dhe në moshë pune. Rrjedhimisht, emigracioni thellon më tej ndikimin e plakjes së popullsisë tek shteti social. Ai gjithashtu kontribuon në "çmontimin" më të shpejtë të modeleve tradicionale të famijes me disa breza, ndikon në rritjen e përqindjes së të moshuarve në familje dhe rrit gjithmonë e më shumë kërkesën për shërbime kujdesi, të cilat përndryshe garantohen brenda për brenda familjeve të mëdha. Nga ana tjetër, nuk duhet lënë pa marrë në konsideratë dukuria e ardhurave nga emigracioni

20 Aktualisht është pranuar fakti se efikasiteti i politikave demografike duhet të vlerësohet mbi bazën e rezultateve në të gjitha sferat, dmth edhe në lidhje me uljen e varfërisë dhe punësimin e grave (Letablier, Luci, Math, & Thévenon, 2009).

(remitancat) që ul varfërinë dhe nevojën për ndërhyrjen e shtetit në atë segment. Në vitin 2013, në Kosovë, remitancat sollën rritjen e të ardhurave familjare me pothuajse 40% (Kosovo Agency of Statistics, 2013, p. 30). Sipas të dhënave nga Banka Botërore, remitancat si përqindje e PBB-së janë shumë të larta në vendet e Ballkanit Perëndimor, ndër më të lartat në Evropë. Në vitin 2015, kjo përqindje ishte në veçanti e lartë në Kosovë (16.7%), dhe në nivel midis 9% dhe 11% në Serbi, Shqipëri, Malin e Zi dhe Bosnje-Hercegovinë²¹. Megjithatë, remitancat potencialisht gjithashtu kontribuojnë në ngurtësi të tregut të punës duke rritur nivelin më të ulët të pranueshëm të pagës (Kovtun, Meyer Cirkel, Murgasova, Smith, & Tambunlertchai, 2014, p. 20) (Kosovo Agency of Statistics, 2013, p. 35). Fakti që në shumicën e vendeve, emigracioni nënkupton largimin e ndjeshëm të "trurit", ngre nevojën e vendosjes së prioritetit për investime në sferën e arsimit (si p.sh. zhvillimi në fëmijëri të hershme përkundrejt arsimit të lartë) dhe politikave për thithjen e personave të kthyer nga emigracioni dhe/ose shfrytëzimi i avantazheve të diasporës së arsimuar (Zeneli, Cosic, Dzebo, & Zmejkoski, 2013) (Gedeshi & Jorgoni, 2012). Dhe së fundi, përvoja e Kroacisë vërteton kanosjen e një vale të fuqishme emigracioni në vitet menjëherë pas anëtarësimit në BE.

Perspektiva afatgjatë sjell edhe më shumë arsye për shqetësim, duke qenë se shpopullimi dhe plakja e theksuar e popullsisë parashikohet të ndikojnë në të gjitha rajonet e Ballkanit Perëndimor. Sipas parashikimeve të Kombeve të Bashkuara deri në vitin 2050, numri i popullsisë në të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor do të vijë në rënie, ku më e theksuar kjo rënie do të jetë në Bosnje-Hercegovinë, Kroaci dhe Serbi. Përqindja e personave në moshën mbi 80 vjeç do të rritet nga niveli aktual, tek 2% në 9% - 10%, përkatësisht në Shqipëri dhe Maqedoni (UNFPA, 2015, pp. 27-30).

3. Probleme të theksuara sociale – varfëri e përhapur, papunësi e lartë dhe ndryshime të tregut të punës

Në krahasim me nivelet evropiane, varfëria dhe rreziku i rënies në varfëri mbeten të larta në vendet e Ballkanit Perëndimor. Po kështu mbeten të larta nivelet e varfërisë absolute të matura mbi konsumin, sipas nivelit të varfërisë prej 3.1 dhe 1.9 dollarësh

21 <https://www.worldbank.org/en/topic/migrationremittancesdiasporaissues/brief/migration-remittances-data>



ndërkombëtarë, ende e pranishme në të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor. Në rajon, nivelet më të larta të varfërisë shënohen në Maqedoni²², Shqipëri dhe Kosovë.

Në vendet që gjithashtu monitorojnë varfërinë absolute të matur mbi bazën e konsumit sipas kriterëve kombëtarë, përqindja e popullsisë që nuk është në gjendje të plotësojë nevojat bazë është e lartë, duke nisur nga afro 8% (Serbi, Mali i Zi, sipas Anketës së buxhetit të familjes për vitet 2014 dhe 2013, përkatësisht) deri në maksimale 14.3% në Shqipëri (2012, sipas Anketës për Matjen e Standardeve të Jetesës – LSMS). Përqindjet e varfërisë të matura kështu nuk janë të krahasueshme mes tyre, por vlen të theksohet se sondazhet e standardit të jetesës sipas konsumit bazohen në metodologjinë e Bankës Botërore²³.

Ndryshe nga këto vende, Bosnje– Hercegovina përdori variantin e monitorimit të varfërisë relative mbi bazën e konsumit, e cila në vitin 2011, sipas Anketës së buxhetit të familjes²⁴ ishte tek 17.9%.

Sipas të dhënave të vitit 2015, në vendet që monitoruan varfërinë sipas nivelit të varfërisë relative të matur mbi bazën e të ardhurave relative (Kroacia, Serbia dhe Maqedonia), përqindja e popullatës në rrezik për të rënë në varfëri ishte e lartë, mbi 20%. Në Serbi, një në katër persona është në rrezik për të rënë në varfëri, njësoj si në Rumani, vendi me përqindjen më të lartë të rrezikut të rënies në varfëri në BE. Në vitin 2015, përqindja mesatare e rrezikut për të rënë në varfëri për vendet e BE-së 28 ishte 17.3%.

Studime më të detajuara tregojnë se në vendet e Ballkanit Perëndimor, varfëria shprehet kryesisht si fenomen rural dhe personat e papunë, pa arsimin e duhur, familjet me fëmijë, dmth familjet me shumë persona janë edhe ata që janë më vulnerabël²⁵. Megjithatë, përqindja e popullsisë urbane në strukturën e të varfërve mbetet gjithashtu e rëndësishme, në veçanti në vendet që monitorojnë riskun e varfërisë së matur mbi bazën e të ardhurave, edhe personat e punësuar gjenden gjithmonë e më shumë përballë këtij risku.

Pabarazitë rajonale janë po ashtu të theksuara në të gjitha vendet. Për ilustrim, popullsia e Serbisë lindore dhe jugore është dy herë më e varfër nga mesatarja (përqindja e varfërisë e bazuar tek konsumi ishte 18.0%), dhe qyteti i Kukësit në Shqipëri është

22 Të dhënat më të fundit krahasuese për varfërinë që lidhet me konsumin në Maqedoni i takojnë vitit 2008. Për nivelin e varfërisë, Banka Botërore ka bërë vlerësimin mbi bazën e sondazhit SILC, se përqindjet absolute dhe ekstreme të varfërisë të matur mbi bazën e të ardhurave në Maqedoni ishin përkatësisht 11.7% dhe 6.3%, përkatësisht, në vitin 2013 (World Bank, 2016, p. 8). Në vendet me të ardhura të larta në natyrë, matja sipas të ardhurave, në vend të konsumit jep vlera më të larta për këtë tregues.

23 Shihni p.sh, 'Metodologjia procjene siromaštva u Crnoj Gori' <https://www.monstat.org/cg/page.php?id=73&pageid=73> and <http://www.instat.gov.al/en/themes/living-standard.aspx>

24 http://www.bhas.ba/saopstenja/2014/BHAS_HBS_BH_dv5-2.pdf

25 Shihni burimet përkatëse të cituara në Tabelën nr. 3.

1.5 herë më i varfër (niveli i varfërisë 22.5%). Në Malin e Zi, pjesa veriore dhe qendrore është tri herë më e varfër nga pjesa jugore (përkatësisht 10.3% dhe 3.8%)²⁶.

Në pothuajse të gjitha vendet, popullata rome është shumë vulnerabël dhe niveli i varfërisë nuk mund të vlerësohet siç duhet, sipas sondazheve mbi konsumin dhe të ardhurat. Në vendet ku UNICEF-i ka zhvilluar sondazhin e vet MICS dokumentohet vulnerabilitet i theksuar i popullsisë rome²⁷.

Tabela nr. 3. Varfëria në vendet e Ballkanit Perëndimor, vite të ndryshme (%)

Shteti	AL	BA	HR	XK*	ME	MK	RS
Treguesi							
Varfëria absolute e matur mbi bazën e konsumit, 1.9 2011 PPP \$ line (2013)	1.1 ²	0.1 ¹	0.9 ²	0.8	1.0	1.3 ³	0.2
Varfëria absolute, 3.1 2011 PPP \$ line (2013)	6.8 ²	0.5 ¹	2.2 ²	3.5	2.5	8.7 ³	1.3
Varfëria absolute e matur mbi bazën e konsumit sipas kritereve kombëtare (2013)	14.3 ²	-	-	29.7 ¹	8.6	-	8.6
Koeficienti Ginii për konsumin (2013)	26.9 ²			27.6 ¹	26.2		26.0
Varfëria relative e matur mbi bazën e të ardhurave relative – përqindja e rrezikut për të rënë në varfëri (2015)	-	-	20.0	-	-	21.5	25.4

Burimi: varfëria absolute në PPP \$ – baza e të dhënave e Bankës Botërore <http://povertydata.worldbank.org/poverty/home/>;

Varfëria sipas kritereve kombëtare dhe koeficientit Gini (Mijatović, 2014)(Zavod za statistiku Crne Gore, 2014)(World Bank, 2013)(INSTAT, World Bank, 2013)

Në rrezik për tu gjendur në varfëri – Baza e të dhënave e Eurostatit, Tabelat: Përqindja e rrezikut për tu gjendur në varfëri sipas pragut të varfërisë, gjinisë dhe moshës – anketa EU-SILC

Shënime: ¹2011; ²2012; ³2008.

26 Ibid.

27 Shihni p.sh: (Republički zavod za statistiku i UNICEF, 2015) (Kosovo Agency of Statistics, 2014) (Zavod za statistiku Crne Gore, 2014) (Ministarstvo za ljudska prava i izbjeglice Bosne i Hercegovine i Agencija za statistiku Bosne i Hercegovine, 2013)



Duke gjykuar sipas sondazheve për buxhetin familjar, pabarazia nuk është ende e lartë në vendet e Ballkanit Perëndimor, dhe koeficienti Gini është afërsisht 26. Koeficienti Gini për të ardhurat është shumë më i lartë në Maqedoni dhe Serbi (33.7 dhe 38.2 në vitin 2015)²⁸, pjesërisht për faktin se sipas metodologjisë SILC të BE-së, tek të ardhurat nuk hyjnë mallrat dhe shërbimet e prodhuara nga familja për përdorim personal (të ardhura në natyrë). Kështu, hendeuku i të ardhurave midis familjeve bujqësore dhe të tjerave zgjerohet, ndërsa hendeuku i konsumit ngushtohet.

Karakteristikat e theksuara të pafavorshme të tregut të punës në vendet e Ballkanit Perëndimor përfaqësojnë një nga sfidat më të mëdha për zhvillimin dhe për politikat sociale. Nivelet e punësimit dhe aktivitetit janë të ulëta, ndërsa ato të papunësisë janë të larta në të gjitha vendet dhe edhe më e përkeqësuar është situata e krahasuar me vendet e BE-së. Njëkohësisht, niveli i papunësisë tek të rinjtë është dy herë më i lartë sesa totali i papunësisë²⁹. Edhe Kroacia, ku tregu i punës është në pozitë më të favorshme në krahasim me vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor, ende është mjaft larg mesatares së BE-së(28), në veçanti po të merret në konsideratë aspekti gjinor.

Tabela nr. 4. Tregu i punës në vendet e rajonit të Ballkanit Perëndimor, grupmosha 15–64 vjec, indikatorë të përzgjedhur, 2015 (me %)

shteti treguesi	AL	BA	HR	K*	ME	MK	RS	EU (28)
Përqindja e papunësisë	17.5	28.2	16.5	32.9	17.8	26.3	18.5	9.4
Përqindja e aktivitetit	64.2	54.6	66.8	37.6	62.6	64.9	63.7	72.5
Përqindja e aktivitetit të grave	55.0	42.9	62.2	18.1	56.9	52.0	55.7	66.8
Përqindja e punësimit	52.9	39.2	55.8	25.2	51.4	47.8	51.7	65.6

Burimi: BE (28) – Baza e të dhënave e Eurostatit, Tabelat: *Papunësia sipas gjinisë dhe moshës – mesatarja vjetore dhe punësimi dhe aktiviteti sipas gjinisë dhe moshës – të dhëna vjetore*; vende të tjera dhe Kosova – Sondazhet për krahun e punës 2015

Shënim: niveli i papunësisë për vendet e BE-së(28) i referohet të gjithë popullsisë


²⁸ Baza e të dhënave e Eurostatit, Tables *Gini coefficient of equivalised disposable income – EU-SILC survey*

²⁹ http://ec.europa.eu/eurostat/statistics-explained/index.php/Enlargement_countries_-_labour_market_statistics

Situata paraqitet veçanërisht e vështirë në Kosovë, ku vetëm një në katër persona në moshë pune është i punësuar dhe një në tre është i papunë. Në Bosnje- Hercegovinë dhe Maqedoni, treguesit janë më të pafavorshëm në krahasim me vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor.


Karakteristikat strukturore tregojnë se situata e tregut të punës është edhe më negative nga ç'del nga shifrat e përgjithshme, pa disagregim. Niveli i papunësisë dhe mungesës së aktivitetit tek të rinjtë, mungesa e aktivitetit ekonomik tek gratë dhe përqindja e të papunëve afatgjatë janë në veçanti të larta. Madje, edhe në Kroaci, niveli i papunësisë tek të rinjtë është dyfishi i asaj në BE (28), ndërsa në Bosnje-Hercegovinë dhe Kosovë, niveli i papunësisë arrin deri afro në 60%. Në Kosovë, gratë thuajse nuk janë fare pjesë e tregut të punës (niveli i aktivitetit është vetëm 18.1%) dhe kjo është karakteristike edhe për Bosnje- Hercegovinën (42.9%).

Figura 1. Përqindja e të papunëve afatgjatë (gjatë një viti), 2015 (%)



Burimi: Sondazhi për krahun e punës 2015; Serbi – të dhëna të rishikuara (Republički zavod za statistiku Srbije, 2016); Shqipëria (Instituti i Statistikave, 2016)

Figura 2. Përqindjet e papunësisë tek të rinjtë dhe gratë, 2015 (%)



Burimi: Sondazhet për krahun e punës 2015; Serbia – të dhëna të rishikuara (Republički zavod za statistiku Srbije, 2016); Shqipëria (Instituti i Statistikave, 2016)

Së fundi, pabarazi ka edhe midis rajoneve. Kështu, p.sh. në Maqedoni, niveli i papunësisë varion nga 16.7% në pjesën juglindore, në 43.2% në pjesën verlindore (State statistical office of the Republic of Macedonia, 2016, p. 128). Në Kroaci, në vitin 2016, niveli i papunësisë në Zagreb ishte katër herë më i ulët sesa në Virovitica – krahina e Podravinës (përkatësisht 8.6% dhe 32.6%) (Ministarstvo regionalnoga razvoja i fondova Europske Unije, 2017).

Niveli i papunësisë, në vetvete nuk është tregues i mjaftueshëm, sepse edhe cilësia e punësimit ka rëndësinë e saj, duke pasur parasysh sidomos përhapjen e ekonomisë informale në vendet e Ballkanit Perëndimor. Sondazhet për krahun e punës tregojnë se në Serbi, Maqedoni dhe Malin e Zi³⁰, një në pesë persona të punësuar punon në ekonominë informale (përkatësisht 20.4%, 19.2%, 22.3%), ndërsa për Shqipërinë ky tregues është një në tre (34.1%), duke theksuar se kjo shifër ka të bëjë me personat që nuk janë të punësuar në sektorin jobujqësor. Kjo përqindje e "personave të punësuar" vjen kryesisht nga shtresat e varfra shoqërore (World Bank, 2016, pp. 33,35), që nuk kanë as sigurime shoqërore dhe as mbrojtje sociale, shpesh fitojnë më pak dhe nuk kontribuojnë në të ardhurat e përgjithshme të buxhetit publik dhe në fondet sociale që sigurojnë financim për përfitime të ndryshme. Si rrjedhojë e tranzicionit të vonuar, një

30 http://www.nhdreport.me/download/Crna%20Gora_Nacionalni%20izvjestaj%20o%20razvoju%20po%20mjeri%20covjeka%202016_Neformalni%20rad.pdf

përqindje e mirë e personave të punësuar punojnë në sektorin bujqësor, zakonisht pa akses në sistemin e mbrojtjes shoqërore.

Situata negative e tregut të punës rëndohet më tej nga mospërputhja e arsimit me ofertën e vendeve të punës; dijet dhe aftësitë profesionale kërkojnë rifreskim me kalimin e kohës, sidomos në rastin e të papunëve afatgjatë; mungesa e dëshirës së punëdhënësve për të investuar në trajnimin e punëmarrësve; si edhe ofertat e papërshtatshme dhe të pamjaftueshme të programeve të arsimit për të rriturit dhe të të mësuarit gjatë gjithë jetës (Arandarenko & Bartlett, 2012, p. 6).

Në një analizë të kohëve të fundit, FMN-ja nuk evidenton më arsye të institucionale, institucionet e ngurta të tregut të punës (mbrojtja e tepruar ndaj largimit nga puna, shpërblime të larta në largim dhe përfitimet e papunësisë, etj.) apo kostot e larta të krahut të punës (ndonëse kjo ka të bëjë me disa segmente specifike të tregjeve në Serbi, Bosnje-Hercegovinë dhe Maqedoni) si shkaqet kryesore të situatës të pafavorshme të tregut të punës. Problemet kryesore janë të një natyre strukturore dhe kanë të bëjnë me qëndrueshmërinë makroekonomike dhe përmirësimin e klimës së investimeve (Kovtun, Meyer Cirkel, Murgasova, Smith, & Tambunlertchai, 2014).

Hulumtime të tjera të kryera nga institucione ndërkombëtare (ILO dhe Banka Botërore) gjithashtu e vendosin theksin tek aspekte të strukturës tatimore (tatimet direkte përkundrejt atyre indirekte), barra tatimore dhe ajo e kontributeve shoqërore për të punësuarit me paga të ulëta, si edhe kundërnxitës për punën si taksa dhe sisteme të mbrojtjes shoqërore (Arandarenko, 2015, pp. 7-9).

Duke gjykuar nga komentet e Komisionit Evropian në lidhje me Programet e Reformës Ekonomike është thelbësore të përmirësohen kapacitetet e shërbimeve të punësimit në të gjitha vendet³¹.

Varfëria e përhapur, përqindjet e larta të punësimit në sektorin informal, dhe sidomos niveli i lartë i papunësisë vendosin kërkesa të larta në shtetet e brishta sociale të vendeve të Ballkanit Perëndimor. Rrjetet e sigurimeve shoqërore nuk arrijnë të sigurojnë mbrojtje për një përqindje të madhe të kuintilit më të varfër; rrjedhimisht, të metat kryesore të këtyre skemave kanë të bëjnë me nivelin e ulët të mbulimit (marzh i lartë i gabimeve në përjashtim) dhe pamjaftueshmërinë e përfitimeve (World Bank, 2011) (Tesliuc, Pop, Grosh, & Yemtsov, 2014). Pavarësisht nga marzhi i ulët i gabimeve në përfshirje në skemë në shumicën e vendeve, përhapja e madhe e ekonomisë gri, si edhe faktorë të tjerë si: të ardhurat nga emigracioni apo të ardhurat në natyrë nga bu-

31 http://europa.eu/rapid/press-release_MEMO-16-1912_en.htm



jqësia pengojnë shënjestrimin dhe përjashtojnë mundësinë e zgjerimit të skemave, për shmangien e përfshirjes së personave që nuk janë në të vërtetë vulnerabël.

Një pjesë e problemit sigurisht ka të bëjë me kapacitetet legislative dhe institucionale, si edhe me mungesën e transparencës dhe përgjegjshmërisë (Gerovska-Mitev, 2015, p. 86). Numri i madh i personave të varfër dhe të papunë është sfidë për kapacitetet e shërbimeve sociale (kryesisht qendra të shërbimeve sociale në ish shtetet jugosllave) dhe për kapacitetet e shërbimeve kombëtare të punësimit. Hendeku midis numrit të popullsisë që gjendet në kushte vulnerabiliteti dhe kapaciteteve institucionale ngre çështjen e aktivizimit dhe politikave të tjera aktive të tregut të punës, si strategji e përgjithshme.

Së fundi, në këto rrethana, një tjetër sfidë qëndron tek përcaktimi i shumave të mjaftueshme për ndihmën financiare shoqërore dhe përfitimet e tjera sociale që do të mundësonin përmbushjen e nevojave bazë, pa ulur stimulën për të punuar, duke pasur parasysh nivelin e ulët të pagës minimale dhe asaj mesatare (Matković, Mijatović, & Stanić, 2014, pp. 19–22). Studimet në rastin e Serbisë kanë treguar se heqja graduale e ndihmës, ndonëse atraktive në kontekstin e teorisë ekonomike, kërkon një rritje të madhe të fondeve të ndihmës financiare sociale (Žarković – Rakić et al., 2017).

Në periudhën afatgjatë, me zhvillimin ekonomik, ndryshimet në rolet tradicionale të familjes dhe venitjen e influencës fetare dhe kulturore³² parashikohet një rritje e integritit të grave në tregun e punës, në veçanti në Bosnje– Hercegovinë, Maqedoni dhe Kosovë. Ndonëse rritja e aktivitetit ekonomik dhe punësimit në përgjithësi ka pasur një ndikim pozitiv në zhvillimin ekonomik dhe ka ulur trysnitë mbi shpenzimet shoqërore, këto ndryshime sjellin kërkesa shtesë për shtetin social, e zhvendosin theksin nga familja tek shteti, sidomos për fëmijët dhe kujdesin për të moshuarit dhe nxjerrin në pah nevojën për shpenzime më të larta për balancimin e marrëdhënies punë-familje.

Kushtet e pafavorshme të tregut të punës, duke përfshirë hyrjen e vonuar të të rinjve në forcën e punës, ndërprerjet e shpeshta të punës dhe puna në ekonominë gri ndikojnë negativisht në sigurinë e moshës së madhe për brezat aktualë (Schwarz A. M., et al., 2014). Është me pikëpyetje deri në ç'masë sistemet e pensioneve, të cilat janë bazuar kryesisht tek sigurimet, do të jenë në gjendje të sigurojnë përfitime të mjaftueshme/përshtatshme për pensionin. Në të tilla rrethana, sfida kryesore nuk do të qëndrojë më

32 Një studim mbi tregjet e punës në vendet e Ballkanit Perëndimor thekson se një nga shpjegimet për diferencat gjinore mund të jetë për shkaqe mentaliteti dhe fetare, si edhe për shkak të rolit tradicional që iu vishet grave (Banka Botërore; Instituti për Studime Ekonomike Ndërkombëtare, Vienë, 2017, fq.7)



tek qëndrueshmëria e sistemit të pensioneve, por tek ruajtja e standardit të jetesës për të moshuarit dhe të shmangia e varfërisë mes tyre.

4. Ndryshimet në strukturën familjare – nuk janë ende alarmante, sfida qëndron tek e ardhmja e afërt

Në dritën e konceptit të tranzicionit të dytë ekonomik (Lesthaeghe, 2014), pjesa më e madhe e vendeve të zhvilluara evropiane përballen jo vetëm me nivele vazhdimisht të ulëta të pjellorisë, por edhe me ndryshime në sferën e martesave dhe rritje të formave alternative të familjes. Shtimi i rasteve të bashkëjetesës, divorcet, lindjet jashtë martese dhe familjet me një prind nga njëra anë, dhe zhdukja e familjeve të mëdha, nga ana tjetër kanë ndikuar në nevojën e zgjerimit të aktiviteteve të shtetit social.

Ndryshime po ndodhin edhe në vendet e Ballkanit Perëndimor; kështu, p.sh. Serbia dhe Kroacia po u afrohen shifrave të vendeve të BE-së(28) për sa i përket numrit mesatar të anëtarëve të një familjeje dhe përqindjes së familjeve të përbëra nga një person. Megjithatë, mbetet për t'u theksuar se rajoni i Ballkanit Perëndimor në këtë aspekt është i polarizuar, si pasojë e pabarazive në fazat e tranzicionit demografik dhe strukturës moshore. Kështu p.sh. në Kosovë, njëësia ekonomike familjare është tre herë më e madhe dhe përqindja e njësisë ekonomike familjare me një person dhjetë herë më e ulët nga vendet e BE-së28, ndërsa në shumicën e vendeve të Ballkanit Perëndimor, vlerat e këtyre dy treguesve qëndrojnë mes "ekstremeve të regjistruara". Megjithatë, si në Shqipëri ashtu edhe në Maqedoni, njësitë ekonomike familjare janë dy herë më të mëdha nga ato në vendet e BE-së dhe modeli i familjeve me një person ende nuk është i përhapur.

Megjithatë, pabarazitë nuk janë aq të mëdha kur vjen fjala tek të dhënat që lidhen me dukurinë e divorcit. Në shumicën e vendeve, përqindjet e përgjithshme të divorcit janë shumë më poshtë nga niveli në vendet e BE-së(28). Ndryshimet disi më të ngadalta në martesë, së paku në disa vende mund t'i atribuohen pjesërisht varfërisë së përhapur, si edhe përpjekjeve për të ruajtur standardin e jetesës. Në Serbi, gjatë krizës së zgjatur ekonomike, shoqërore dhe politike të viteve 90-të u shënua edhe një rënie e numrit të divorceve, në kushtet e "ruajtjes me detyrim të martesës dhe familjes, duke ngrirë konfliktet dhe ndaluar proceset e transformimit" (Bobić & Vukelić, 2011, p. 163). Disa humlume kanë nxjerr në pah se në Serbi, si rezultat i strategjive për përshtatje, një numër i madh familjesh me një prind të vetëm dhe madje edhe personat që bashkëjetojnë zgjedhin të jetojnë si pjesë e njësisë të mëdha ekonomike familjare (Petrović, 2011, p. 65).

Tabela nr. 5. Madhësia e njësive ekonomike familjare (NJEF), përqindja e familjeve me një person dhe përqindjet e përgjithshme të divorcit, 2015

Shteti	AL	BA	HR	XK*	ME	MK	RS	EU (28)
Treguesi								
NJEF mesatare (2015)	3.9 ¹	3.1 ³	2.8	5.9 ¹	3.2	3.7	2.9	2.3
Përqindja e NJEF të përbëra nga një person (2015) (%)	6.5 ¹	18.8 ³	24.9	2.9 ¹	18.1 ¹	9.7	22.3	32.3
Përqindjet e përgjithshme të divorcit (2013) (‰)	1.3	0.6 ²	1.4	0.7 ²	0.8	1.0	1.1	2.0 ¹

Burimi: NJEF mesatare – NJEF mesatare – sondazhi EU-SILC, B&H (Agjencia za statistiku Bosne i Hercegovine, 2016). Kosovë (Kosovo Agency of Statistics, 2011), Mali i Zi (Vlada Crne Gore Zavod za statistiku, 2016)


Përqindja e NJEF të përbëra nga një person: Serbia, Maqedonia, Kroacia dhe BE (28) – Baza e të dhënave e Eurostatit, Tabelat Shpërndarja e familjeve sipas llojit të familjes nga viti 2003 e më tutje – sondazhi EU-SILC, B&H (Agjencia za statistiku Bosne i Hercegovine, 2016), Kosova (Kosovo Agency of Statistics, 2011), Mali i Zi (Zavod za statistiku Crne Gore, 2013), Shqipëria (De Bruijn, Eelens, Schoorl, Galanxhi, Nesturi, & Hoxha, 2014)

Përqindjet e divorcit – Baza e të dhënave e Eurostatit, Tabelat Treguesit e divorcit, Shqipëria (Instituti i Statistikave, 2014)

Shënim: ¹ 2011, ² 2012 ³ 2013

Sipas të dhënave të SILC–ut, përqindja e NJEF (familjeve) me një prind të vetëm, si pjesë e totalit të familjeve në përgjithësi në Kroaci dhe Maqedoni është gjithashtu e ulët, pothuajse dy herë më e ulët nga mesatarja e BE–së(28). Kjo përqindje është më e lartë në Serbi, ndonëse mbetet shumë më e ulët nga vendet e tjera ku tranzicioni i dytë demografik ka avancuar (mbi 5%, dhe madje edhe 6% në shumicën e vendeve më të zhvilluara të BE–së).

Figura 3. Përqindja e NJEF me një prind, me fëmijë, përqindjet e NJEF në rrezik për t'u gjendur në varfëri, NJEF gjithsej dhe NJEF me një prind, 2015 (%)



Burimi: Baza e të dhënave e Eurostatit, Tabelat: Shpërndarja e familjeve sipas llojit të familjeve nga viti 2003 e më pas – Sondazhi EU-SILC dhe Përqindja e rrezikut për t'u gjendur në varfëri sipas pragut të varfërisë dhe llojit të familjes – sondazhi EU-SILC

Sfidat me të cilat përballen shtetit social si pasojë e ndryshimeve të modelit të familjes reflektohen pikësëpari në rolin në turrje të kësaj të fundit në sigurimin e mbrojtjes, kujdesit për fëmijët dhe në veçanti për kujdesin afatgjatë. Ulja e numrit të familjeve të mëdha tradicionale, bashkë me nivele më të larta të punësimit të grave dhe ndryshimet në rolet gjinore dobësojnë kapacitetet e njësive ekonomike familjare për t'u kujdesur për të moshuarit dhe fëmijët dhe krijojnë më shumë hapësira për përfshirje më të madhe të ofruesve privatë apo institucioneve publike në këtë sferë. Nga ana tjetër, shtimi i numrit të familjeve me një prind, të cilët përgjithësisht jetojnë në kushte pasigurie më të lartë ekonomiko-shoqërore kërkojnë gjithashtu mbështetje më të madhe nga shoqëria (Esping-Andersen G., 2006). Siç ilustron Figura 3, familjet me një prind janë shumë më vulnerabël nga mesatarja, në veçanti në vendet e BE-së. Në kuadrin e konstatimeve të punës kërkimore referuar më sipër mundet që dallimet e vogla në vulnerabilitet midis familjeve me një prind të vetëm dhe popullsisë në përgjithësi në vendet e Ballkanit Perëndimor të jenë rezultat i faktit që më të varfrit mbeten brenda familjes së madhe qoftë me zgjedhjen e tyre/qoftë nga halli (nevoja), ndërsa vetëm ata që nuk konsiderohen vulnerabël sipas një niveli të konsideruar si mesatar krijojnë familjet e tyre.



Trysnia mbi shpenzimet e shtetit social për të garantuar shërbimet për fëmijët dhe të moshuarit, si edhe trysnitë që rrjedhin nga mbështetja më e madhe financiare për familjet me një prind do të përbëjnë një sfidë, e cila ende nuk është shfaqur plotësisht, veçanërisht në ato vende ku ndryshimet në sferën familjare nuk janë ende të theksuara (Shqipëria, Maqedonia). Në Kosovë, ku gjysma e popullsisë jeton ende në familje të mëdha dhe ku veprimtaria ekonomike e grave mbetet shumë e ulët, sfidat do të krijohen më vonë.

Numri dhe përqindja në rritje e (NJEJ)/familjeve me të moshuar, në veçanti familjeve me një person, si pasojë e shpërbërjes së familjeve tradicionale, plakjes së popullsisë dhe emigracionit; që tani kanë krijuar sfida për Serbinë dhe Kroacinë. Kjo është veçanërisht e dukshme në nivelin e bashkive të vogla, të pazhvilluara që kanë pasur emigracion, sidomos po të merret në konsideratë fakti se shërbimet e kujdesit shoqëror financohen nga buxhetet e pushtetit vendor. Sipas të dhënave të SILC-it për vitin 2015, në Kroaci 29% e të moshuarve jetonin në familje me nga një person, ndërsa në Serbi kjo përqindje ishte tek 24.5%³³. Në të ardhmen, këto vende, si edhe i gjithë rajoni i Ballkanit Perëndimor pritet të përballen me një rritje të përshpejtuar të numrit të familjeve të përbëra vetëm nga të moshuar, si edhe me rritjen e vulnerabilitetit dhe kërkesës për shërbime të kujdesit social.

5. Cilësia e arsimit dhe kujdesit shëndetësor lënë për të dëshiruar

Rezultatet si për arsimin, ashtu edhe për shëndetësinë paraqiten të pafavorshme, çka reflekton probleme të cilësisë të shtetit social dhe shton sfidat e së ardhmes me të cilat përballlet sektori social.

Rezultatet e sondazhit të PISA³⁴-s janë një tregues i mundshëm për vlerësimin si të cilësisë, ashtu edhe të efikasitetit të arsimit. Përqindja e nxënësve që kanë nivele të ulëta arritjesh mësimore njëkohësisht në shkenca, lexim dhe matematikë është shumë e lartë në të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor, përjashtim këtu bën Kroacia (14.5%). Megjithatë, edhe Kroacia nuk mund të konsiderohet e kënaqur me rezultatet e saj, kur krahasimi bëhet me pjesën dërrmuese të vendeve të BE-së, ku shifra koresponduese

33 Shifra koresponduese për Maqedoninë është pothuajse dy herë më e ulët (15.1%). Baza e të dhënave e Eurostatit, Tabelat: Shpërndarja e popullsisë në moshën 65 vjeçare e lart, sipas llojit të NJEF - anketa EU-SILC

34 PISA – Programi për vlerësimin ndërkombëtar të nxënësit

rrallë e tejkalon afërsisht dhjetë përqindshin. Sipas Komisionit European (2015, p. 4) në Kroaci janë kryesisht mbrapa në matematikë. Në Maqedoni dhe ndë Kosovë, përqindja e nxënësve me arritje të ulëta në të trija këto fusha e kalon 50% (OECD, 2016).

Të dhënat e vitit 2015 për nxënësit që braktisin shkollën janë shqetësuese, sidomos për Shqipërinë dhe Bosnje– Hercegovinën, duke qenë se 20% e të rinjve (të moshës 18–24 vjeç) që kanë mbaruar arsimin e mesëm nuk vijojnë më tej me arsimin apo me trainime/kualifikime.

Pabarazitë krahasuar me vendet e BE-së(28) janë veçanërisht të theksuara në fushën e zhvillimit të hershëm të fëmijës dhe ndjekjes së arsimit parashkollor në të gjitha vendet për të cilat disponohen të dhëna. Në Maqedoni, vetëm një në pothuajse katër fëmijë ndjek arsimin parashkollor.

Së fundi, me përjashtim të Kroacisë, përqindja e personave të grupmoshës 30–34 vjeç, të cilët kanë përfunduar arsimin e lartë mbetet e ulët për të gjitha vendet, sidomos për Shqipërinë dhe Bosnje– Hercegovinën, ku shifrat janë dy herë më të ulëta sesa ato për vendet e BE-së(28) – përkatësisht vetëm 16.8% dhe 18.9%.

Të dhënat e MICS–ut tregojnë shkallën/masën deri ku të gjithë faktorët arsimorë janë më të pafavorshëm për popullsinë rome dhe pakicat e tjera vulnerabël etnike në vendet e Ballkanit Perëndimor (Ministarstvo za ljudska prava i izbjeglice Bosne i Hercegovine i Agencija za statistiku Bosne i Hercegovine, 2013) (Kosovo Agency of Statistics, 2014) (Republički zavod za statistiku i UNICEF, 2015). Gjithashtu hulumtime të mëparshme në Serbi tregojnë se kur vjen fjala tek analfabetizmi funksional, rezultatet arsimore të pjesës më të varfër të popullsisë janë shumë të dobëta në krahasim me popullsinë në përgjithësi (Baucal & Pavlović Babić, 2009).

Tabela nr 6. Tregues të përzgjedhur për cilësinë e arsimit dhe shëndetësisë, viti 2014 dhe 2015

Shteti	AL	BA	HR	XK*	ME	MK	RS	EU (28)
Treguesi								
Përqindja e nxënësve me rezultate të ulëta (poshtë nivelit 2) në trija fushat e testimit bashkë (2015) (në %)	31.1	-	14.5	60.4	33.0	52.2	28.5 ²	-
Braktisja e hershme e shkollës (2015) (në %)	21.3	26.3	2.8	-	5.7	11.3	7.5	11.0
% e grupmoshës nga 30–34 vjec me arsim të lartë(2014)	16.8 ²	18.9	32.2	-	28.3	24.9	27.2	37.9
Përqindja e fëmijëve të moshës 4 vjec në arsim parashkollor (2015)	-	-	59.6	-	50.0	26.7	51.3	91.8
Jetëgjatësia (2014)	77.8	76.4	77.3	71.1	76.2	75.3	75.5	80.9
Përqindja e vdekshmërisë foshnjore (2014) (në ‰)	7.9	4.8	5.0	6.6	4.9	9.9	5.7	3.7
Nevojat e paplotësuara për trajtim mjekësor sipas vetë raportimeve (kuintili i parë) (2015)	-	-	2.6	-	13.3 ²	4.7	8.5	4.1

Burimi: përqindja e nxënësve me rezultate të ulëta – PISA (OECD, 2016); % e grupmoshës nga 30–34 vjec që kanë përfunduar arsimin e lartë dhe që e kanë lënë herët shkollën – Baza e të dhënave e Eurostatit, Tabelat *vetet candidate dhe candidate potenciale: arsimi*, Kroacia dhe BE (28) – Tabelat *Arsimi i lartë, grupmosha 30–34 vjec dhe personat që e kanë lënë herët shkollën dhe trainimin, grupmosha 18–24 vjec*; Përqindja e fëmijëve në arsim parashkollor – Baza e të dhënave e Eurostatit, Tabelat *Nxënës në arsim fillor sipas nivelit arsimor dhe moshës – si % e popullsisë së moshës koresponduese*; jetëgjatësia – baza e të dhënave e Bankës Botërore <http://databank.worldbank.org/data/reports.aspx?burimi=2&series=SP.DYN.LE00.IN&country=>

Përqindja e vdekshmërisë foshnjore – *vetet candidate dhe candidate potenciale: popullsia – demografia*, Kroacia dhe vendet e BE-së(28) – Baza e të dhënave e Eurostatit, *përqindja e vdekshmërisë foshnjore*; Baza e të dhënave e Eurostatit, Tabelat *Nevojat e paplotësuara për kontroll mjekësor, sipas vetëraportimeve, sipas gjinisë, moshës, arsyes së detajuar dhe kuintilit të të ardhurave*

Shënim: ¹2012, ²2013

Cilësia e kujdesit shëndetësor dhe aksesit zakonisht vlerësohen me anë të treguesve të "jetëgjatësisë" dhe "përqindjes së vdekshmërisë foshnjore", të cilët konsiderohen si tregues të përafërt të situatës shëndetësore të popullatës³⁵.

Pavarësisht rritjes konstante, jetëgjatësia (pritsmëria jetike) në vendet e Ballkanit Perëndimor mbetet pas mesatares së vendeve të BE-së(28) me afro 3–5 vjet. Sipas standardeve evropiane, niveli i jetëgjatësisë në Kosovë është i ulët, vetëm 71 vjeç. Ky tregues shënon vlerat më të larta në Kroaci, si vendi më i zhvilluar, si edhe në Shqipëri. Megjithatë, Instituti i Statistikave i Republikës së Shqipërisë ka të dhëna që flasin për një mospërputhje midis të dhënave të pritshmërisë jetike nga njëra anë dhe gjendjes së përgjithshme të sektorit shëndetësor dhe përqindjeve të vdekshmërisë foshnjore nga ana tjetër. Sipas Bruijn et. al. (2014, p. 96) konsiderohet se ka një problem me regjistrimin e vdekjeve, përse i përket plotësisë dhe se faktikisht jetëgjatësia në Shqipëri është në nivele më të ulëta (mosha 74.5vjeç, sipas treguesve ekonomiko–shoqërorë).

Përqindja e vdekshmërisë foshnjore në vendet e Ballkanit Perëndimor është shumë më e lartë sesa në vendet e BE-së, me shifra veçanërisht të larta në Maqedoni, Shqipëri dhe Kosovë. Në BE, për këtë tregues janë shënuar vlera të larta vetëm në Bullgari dhe Rumani (7.6%^odhe 8.4%^o).

Pabarazia në lidhje me aksesin në kujdesin shëndetësor është një element tjetër i rëndësishëm i cilësisë së pakënaqshme, po të gjykohet përmes përqindjeve të larta të vdekshmërisë foshnjore të disa pakicave etnike, e veçmas për popullatën rome. Kështu, për ilustrim në Serbi, përqindja e vdekshmërisë foshnjore në popullsinë rome është sa dyfishi i këtij treguesi për popullsinë e përgjithshme, në nivel 13%^o (Republički zavod za statistiku i UNICEF, 2015), në Bosnje–Hercegovinë – pothuajse sa pesëfishi, në nivel 24%^o (Ministarstvo za ljudska prava i izbjeglice Bosne i Hercegovine i Agencija za statistiku Bosne i Hercegovine, 2013), ndërsa në Kosovë, përqindja e vdekshmërisë foshnjore është e lartë mes popullsisë rome, egjiptiane dhe ashkale, në nivel 41%^o (Kosovo Agency of Statistics, 2014). Nivele të tilla të vdekshmërisë foshnjore kaq të larta janë regjistruar vetëm në disa vende të Azisë Jugore dhe në ato të Afrikës Sub-Sahariane.

Aspektet e mungesës së cilësisë, ose cilësisë së pamjaftueshme, në disa vende kanë çuar në shtresëzimin e popullsisë në lidhje me përdorimin e kujdesit shëndetësor. Segmentet më të pasura të popullsisë gjithmonë e më shumë po përdorin shërbimet me

35 BE-ja ka përpiluar shumë tregues socialë në fushën e shëndetësisë dhe kujdesit afatgjatë, një numër i madh prej të cilëve nuk mund të monitorohen në shumë vende të Ballkanit Perëndimor (Nën-grupi i treguesëve të Komisionit për Mbrojtjen Sociale, 2015)



pagesë të sektorit privat. Kështu, për shembull, në Shqipëri, përqindja e pagesave nga xhepi përfaqësonte pothuajse gjysmën e totalit të shpenzimeve për kujdesin shëndetësor. Përqindja përkatëse e këtyre pagesave është po ashtu e lartë në Malin e Zi (42.8%), Maqedoni dhe Serbi (36.7% dhe 36.6%)³⁶.

Nga ana tjetër, për shkak të kostove të larta, nevojat për trajtim nuk arrijnë të përbushen, në veçanti mes shtresave më të varfra. Kështu, p.sh. në Serbi, 8.5% e personave në kuintilin e parë raportohet që nuk janë në gjendje t'i plotësojnë këto nevoja për arsye financiare, ndërsa në Malin e Zi, kjo përqindje arrin 13.3%. Përqindja e popullsisë që raportohet se nuk është në gjendje të plotësojë nevojat për trajtim rritet edhe më tej nëse merren në konsideratë arsye të tjera, si p.sh. distanca nga njësitë e kujdesit e shëndetësor apo listat e pritjes, dhe akoma më tej po të përfshihen këtu nevojat për shërbime dentare.

Rritja dhe përmirësimi i shërbimeve arsimore dhe kujdesit shëndetësor në vendet e Ballkanit Perëndimor kërkon një rritje të ndjeshme të investimeve, si edhe zbatimin e reformave me qëllim përmirësimin e efikasitetit dhe barazisë së të dy sistemeve. Krijimi i hapësirës buxhetore për rritjen e investimeve në një situatë të kontrollit të kujdesshëm të shpenzimeve publike nuk është aspak një detyrë e lehtë, edhe në shoqëri shumë të pasura. Kjo sfidë bëhet edhe më e madhe nga ndërgjegjësimi mbi rëndësinë e arsimit dhe shëndetësisë për cilësinë e kapitalit njerëzor dhe rrjedhimisht edhe ndikimi i tyre në konkurrueshmëri dhe zhvillimin ekonomik.

Përsa i përket kompleksitetit, detyra e hartimit dhe zbatimit të reformave për përmirësimin e cilësisë dhe aksesit e tejkalon problemin e mungesës së fondeve. Kjo ndofta ilustron më mirë nga konstatimi i mëposhtëm i marrë nga *Programi për Punësim dhe Reforma Sociale në procesin e Anëtarësimit në Bashkimin Evropian i Serbisë* (Vlada Republike Srbije, 2014, p. 20): "Nismat për reforma në arsimin formal parauniversitar që kanë nisur qysh nga viti 2000 kanë qenë jetëshkurtra, pa sinkron strategjik dhe të pjesshme dhe shumë shpesh kanë mbetur të papërfunduara". Një tjetër sfidë e rëndësishme me të cilën përballen kapacitetet e dobëta administrative është vendosja e një sistemi për sigurimin e cilësisë.

36 Baza e të dhënave të Bankës Botërore, të dhëna të vitit 2014, <http://data.worldbank.org/indicator/SH.XPD.OOPC.TO.ZS>

6. Akordimi i fondeve për sektorin social – të ulëta dhe të pamjaftueshme për të garantuar mbrojtjen sociale; probleme të dukshme në lidhje me efikasitetin në nivelin mikro

Fondet e akorduara për sektorin social në vendet e Ballkanit Perëndimor janë nën nivelin e atyre të akorduara për vendet e BE-së (28) në terma relativë dhe në veçanti në terma absolute.

Të dhënat për mbrojtjen sociale, sipas metodikës së ESSPROS nga baza e të dhënave e Eurostat-it tregojnë se në vitin 2013, fondet që iu akrodhuan Kroacisë për këto qëllime si përqindje e PBB-së ishin pothuajse 7 pikë përqindjeje më ulët se mesatarja e BE (28) (21.6% në krahasim me 28.7% të PBB), ndërsa në terma absolute, ishin dyfish më të ulta (3460 në krahasim me 7900 PPS për frymë). Serbia nuk ishte edhe aq mbrapa në terma relative (po të flasim në mënyrë "pesimiste" barra e shpenzimeve të sektorit social është më e lartë), por fondet e akorduara ishin tri herë më të ulta në terma absolute (2352 PPS për frymë). Këto fonde kaq të ulëta në terma absolute, megjithatë, jo domosdoshmërisht flasin për pamundësinë e shtetit për të mbrojtur personat e targetuar nga përfitimet, duke qenë se mjaftueshmëria e transfertave sociale në para "cash" vlerësohet kryesisht përkundrejt standardit të jetesës dhe pagave në një vend të caktuar (p.sh. për përfitimet me bazë sigurimet, treguesit e përshtatshmërisë janë normat e zëvendësimit).

Në të dy vendet, shpenzimet për arsimin janë nën mesataren e BE-së(28); megjithatë, struktura e këtyre shpenzimeve është një aspekt kritik, në veçanti përse i takon përqindjes përkatëse të pagesave për mësuesit dhe investimeve në cilësinë e arsimit dhe reformat në totalin e shpenzimeve.


Në Figurën 4 tregohet se cilët sektorë mund të jenë ata që janë më shumë të prekur nga mungesa e efikasitetit në nivel mikro. Kështu, në terma relative, Serbia ka nivel më të ulët fondesh për kujdesin shëndetësor dhe për shkak të barrës së lartë të vendosur nga fatura e pensioneve i afrohet mesatares përse i takon shpenzimeve për të moshuarit, ndërsa fondet e Kroacisë e kalojnë mesataren përse i takon aftësisë së kufizuar ndoshta falë fondeve të larta që janë akorduar për veteranët (Stubbs & Zrinščak, 2015). Si në Kroaci, ashtu edhe në Serbi, financimet për NJEF/fëmijët janë më të ulta, që ndër faktorë të tjerë është rezultat i skemave të targetuara më shumë sesa i skemave të pagesave universale për fëmijë. Për funksionin e papunësisë, duke



qenë se asnjëri nga këto vende nuk ka një skemë asistence për papunësinë³⁷, numri i përfituesve nga pagesat për papunësinë nuk është i madh për shkak të mbizotërimit të të papunëve afatgjatë dhe përqindjes së konsiderueshme të punëkërkuesve për herë të pare. Shpenzimet për politikë aktive të tregut të punës janë të ulëta, në veçanti në Serbi (0.015% e PBB në vitin 2014) (Vlada Republike Srbije, 2014, p. 18). Në Kroaci, shpenzimet e përjashtimit social (kryesisht asistencë sociale financiare) janë të ulëta.

37 Në shumë vende, asistencë për papunësi shpërndahet pasi ka mbaruar pagesa e papunësisë; sipas metodikës ESSPROS, të dyja këto lloj pagesash janë në kuadrin e funksionit të papunësisë
http://ec.europa.eu/eurostat/statistics-explained/index.php/Social_protection_statistics_-_unemployment_benefits

Figura 4. Përqindja e shpenzimeve sipas riskut/funksioneve të mbrojtjes sociale (% e PBB), Kroaci, Serbi dhe vendet e BE-së(28), 2014



Burimi: baza e të dhënave e Eurostat-it, Tabelat *Shpenzimet: rezultatet kryesore*

Si përfundim, të dhënat e SILC-it hedhin dritë mbi efikasitetin e transfertave sociale. Një krahasim i përqindjes së personave në risk për të rënë varfëri përpara dhe pas transfertave sociale (duke përfshirë pensionet) siguron një vlerësim të shkallës deri ku transfertat të ndryshme në *cash* arrijnë të ndihmojnë në lehtësimin e vulnerabilitetit të popullsisë në vende të ndryshme. Efikasiteti i transfertave sociale (duke përfshirë



pensionet) në Serbi në vitin 2015 (31.7%) nuk binte mbrapa vendeve të BE-së⁽²⁸⁾ (33.5%)³⁸, ndërsa në Kroaci e kalonte këtë nivel (35.5%)³⁹. Kështu, në matricën evropiane për vitin 2014, Kroacia ishte ndër vendet e cila kishte treguar efikasitet dhe kishte pasur shpenzime të ulëta (përsa u takon shpenzimeve për mbrojtje sociale, duke përjashtuar pensionet përkundrejt PBB) duke ia dalë të ulte ndjeshëm nivelin e varfërisë (European Commission, 2016, p. 7). Serbia vazhdon të vlerësohet si vend me shpenzime të ulëta, ku ulja e varfërisë ka qenë në po të njejtat nivele (të ulëta).

Përfundime në lidhje me mbrojtjen shoqërore dhe shpenzimet për arsimin në vende të tjera të Ballkanit Perëndimor mund të nxirren vetëm mbi bazën e statistikave kombëtare, të cilat nuk janë të krahasueshme me metodikën ESSPROS. Duke gjykuar nga të dhënat e paraqitura në Programet e Reformës Ekonomike, Shqipëria dhe Kosova bëjnë dallim nga vendet e tjera për nivelin e ulët të shpenzimeve për mbrojtjen shoqërore, me përjashtim të shërbimit shëndetësor në natyrë⁴⁰ (pjesërisht falë strukturës më të re në moshë të popullësisë), përqindjeve shumë të ulëta të shpenzimeve për kujdes shëndetësor (vetëm 2.8% e PBB), dhe Shqipëria spikat po ashtu edhe për shpenzimet shumë të ulëta në sferën e arsimit (2.9%). Nga ana tjetër, niveli i lartë i shpenzimeve për kujdesin shëndetësor dhe arsimin në Bosnje- Hercegovinë është rezultat i një skeme komplekse dhe tejet të decentralizuar të qeverisjes⁴¹, ku treguesit e shëndetësisë dhe arsimit qëndrojnë poshtë mesatares rajonale (IMF, 2015, pp. 7-8).

38 Efikasiteti i transfertave sociale në BE është kryesisht për shkak të përqindjeve të ulta të regjistruara në vendet e Evropës Jugore (Greqi, Itali, Spanjë), si edhe mes shteteve të reja anëtare (me përjashtim të Sllovenisë, Hungarisë dhe Republikës Çeke).

39 Baza e të dhënave e Eurostatit, Table Impact of social transfers (excluding pensions) on poverty reduction (%)

40 Mbrojtja sociale konsiston, kryesisht në shpenzimet për pensione, por përfshin gjithashtu përfitime të tjera sociale dhe shërbime të kujdesit shoqëror.

41 Sistemi është tepër i fragmentuar dhe ineffikas, me 13 ministri dhe po kaq fonde të sigurimit shëndetësor (FMN, 2015, fq. 7).

Tabela nr. 7. Shpenzimet publike për mbrojtjen sociale, kujdesin shëndetësor dhe arsimin, si përqindje e PBB, 2014 (%)

Shteti	AL	BA	HR	XK*	ME ²	MK	RS	EU (28)
Treguesi								
Mbrojtja shoqërore ¹ (ESSPROS)	-	-	21.6	-	-	-	23.4	28.7
Nga e cila për kujdes shëndetësor			(7.1)				(6.0)	(8.1)
Mbrojtja shoqërore, me përjashtim të kujdes shëndetësor në natyrë 1 (ERP)	9.1	14.1	-	4.8	13.4	11.4	-	-
Kujdesi shëndetësor	2.8	6.9	-	2.8	5.9	4.9	-	-
Arsimi	2.9	5.3	5.1 ³	4.1	4.5	3.9	4.2	5.3 ³

Burimi: Mbrojtja sociale për Serbinë, Kroacinë dhe vendet e BE-së(28) – Baza e të dhënave e Eurostatit, Tabelat: *Shpenzimet: rezultatet kryesore*; Arsimi për Serbinë Baza e të dhënave e Eurostatit, Tabelat *vendet candidate dhe kandidate potenciale: arsimi*, Kroaci (Evropska komisija, 2015)

Për vendet e tjera, të dhënat janë marrë nga Programet e Reformës Ekonomike; B&H (BiH Council of Ministers, 2016), Shqipëria (Government of Albania, 2016), Maqedonia (Republic of Macedonia, 2016), Mali i Zi (Government of Montenegro, 2017) dhe për Kosovën (Republic of Kosovo, 2016)

Shënim: Sipas metodikës ESSPROS, shpenzimet për mbrojtjen shoqërore përfshijnë shpenzimet e kujdesit shëndetësor. Në programet e reformave ekonomike, shpenzimet për mbrojtjen shoqërore nuk përfshijnë përfitimet kujdesin shëndetësor në natyrë

²2015³2013

Të dhënat e lartpërmendura nxjerrin në pah disa sfida me të cilat përballen shtetet sociale në vendet e Ballkanit Perëndimor. Pikë së pari, në disa vende, një pjesë e buxhetit të sektorit social është "zënë në grackë" për arsye politike dhe/ose struktura e tij është e paracaktuar (p.sh. për të moshuarit në Serbi apo për veteranët në Kroaci dhe Bosnje– Hercegovinë). Është e qartë që niveli i shpenzimeve në Bosnje– Hercegovinë është shumë i ndikuar nga sistemi ineffikas, tejet i decentralizuar, me dyzina ministrish arsimi dhe shëndetësie. Mungesa e efikasitetit në akordimin e fondeve për qëllime specifike, nga njëra anë dhe mungesa e gatishmërisë për reformimin e përfitimeve që u sigurohen grupeve të privileguara, nga ana tjetër apo përkrahja e zgjidhjeve qartazi ineffikase për qëllime populiste dhe politike nuk janë "sëmundje" specifike për vendet e Ballka-



nit, por pasojat e tyre janë më të rënda në kushtet e varfërisë së përhapur dhe nivelit të pamjaftueshëm të mbrojtjes që u garantohet disa grupeve të caktuara vulnerabël jashtë radhëve të personave të privilegjuar (p.sh. personat me aftësi të kufizuar).

Së dyti, dallimet në strukturën moshore ndikojnë në strukturën e shpenzimeve, por përqindja e ulët e shpenzimeve për kujdesin shëndetësor në Kosovë dhe Shqipëri mund t'u atribuohet këtyre vetëm pjesërisht, sidomos po të kujtojmë rezultatet negative në këtë sferë (si p.sh. përqindjet e larta të vdekshmërisë foshnjore, Tabela nr. 6). Është interesant megjithatë fakti që Maqedonia, treguesit e së cilës gjithashtu janë të pafavorshëm dhe përqindja e shpenzimeve për kujdesin shëndetësor është mbrapa asaj të Kroacisë dhe Serbisë, dhe edhe më pas nga përqindja në vendet e BE-së, po planifikon një rritje graduale të kësaj përqindjeje, por vetëm deri në 5.5% dhe kjo në vitin 2060 (Republic of Macedonia, 2015, p. 41). Nga ana tjetër, në periudhën afatgjatë, është pikërisht ulja e shpenzimeve për kujdesin shëndetësor ajo që do të shënojë edhe sfidën më të madhe për vendet e Ballkanit Perëndimor, duke pasur parasysh jo vetëm plakjen e popullsisë dhe pritshmëritë në rritje, por edhe teknologjitë moderne dhe zhvillimin e mjekësisë, të cilat krijojnë trysni të mëdha për rritjen e fondeve për këto qëllime. Për më tepër, nëse duan të parandalojnë largimin e mjekëve dhe punonjësve të tjerë të sistemit shëndetësor, vendet e Ballkanit Perëndimor do të duhet të rrisin edhe nivelin e pagave, së paku për disa segmente të kujdesit shëndetësor.

Së treti, përqindja e ulët e shpenzimeve për arsim, sidomos në Shqipëri ul mundësitë e përdorimit të potencialit me rëndësi të zhvillimit ekonomik, si edhe të atij për uljen e pabarazive dhe varfërisë në periudhën afatgjatë. Edhe shpenzimet e vendeve të tjera janë të pamjaftueshme, në veçanti po të kujtojmë që duhet krijuar hapësirë shtesë buxhetore brenda shpenzimeve për arsim, për qëllimet e përmirësimit të cilësisë, përfshirjes së fëmijëve me aftësi të kufizuar, për zhvillimin e fëmijërisë së hershme dhe arsimit, për të mësuarin gjatë gjithë jetës dhe reformat që nevojiten për të përmbushur nevojat e tregut të punës. Analiza më e thelluar e mikro-ineficiencave në çdo segment të sektorit social mund të nxirrte në pah edhe probleme të tjera në vende të veçanta, si p.sh. shpenzimet tejet të larta për arsimin fillor, si rrjedhojë e adaptimit të ngadaltë të rrjetit shkollor me numrin në rënie të fëmijëve, nivelin jo të mirë të fondeve për kujdes shëndetësor parësor dhe shëndet publik, përqindje e pamjaftueshme e shpenzimeve që synojnë personat më të varfër, etj.

7. Vlerësimi i efikasitetit dhe efektivitetit të sektorit qeveritar dhe publik është i pafavorshëm

Hendeku midis nevojave të mëdha dhe burimeve të pakta për qëllime sociale në vendet e Ballkanit Perëndimor zgjerohet edhe më tej nga "shtete të dështuara, të dobëta, autoritare, të kapura/klienteliste" (Stubbs, 2005, p. 73). Sipas një vlerësimi të Bankës Botërore, në vendet e Ballkanit Perëndimor, sektori publik është i madh dhe nuk është efikas, ndërsa shërbimet publike e ofruara prej tij janë tepër të kushtueshme (Svetska banka, 2015, p. 20).

Matja e efikasitetit dhe eficiencës së sektorit publik dhe qeverisjes bazohet kryesisht mbi perceptime, të cilat ndonëse nuk përfaqësojnë tregues objektivë mund të shërbejnë si vlerësime të përafërta.

Banka Botërore përdor 6 tregues për matjen e cilësisë së qeverisjes, duke përfshirë edhe efikasitetin qeverisës⁴². Ky tregues kap perceptimin e cilësisë së shërbimeve publike, cilësisë së shërbimit civil dhe shkallën e pavarësisë nga presionet politike, cilësisë së hartimit dhe zbatimit të politikave dhe besueshmërinë e angazhimit të qeverisë ndaj këtyre politikave. Vlera e treguesit shprehet me njësi të një shpërndarjeje standarde normale, duke nisur nga afërsisht -2.5 to 2.5, dhe rendi i percentileve tregon se ku është i pozicionuar një shtet i caktuar në rang ndërkombëtar.

Sipas treguesit të "efikasitetit qeverisës", pjesa më e madhe e vendeve të Ballkanit Perëndimor janë shumë pas vendeve të zhvilluara dhe renditen diku midis percentilit 54-60, pra, rreth mesatares në terma globalë. Kështu, p.sh. ky tregues është në nivelin 1.85 në Danimarkë, dhe sipas perceptimit të shtetasve danezë në lidhje me këtë tregues, Danimarka qëndron më mirë se 97.6% e të gjitha vendeve në botë (ranku i percentileve).

Perceptimi për efektivitetin qeverisës është dukshëm i ulët në Bosnje- Hercegovinë dhe Kosovë. Në rajonin e Ballkanit Perëndimor, vlerësimet e perceptimit janë të bazuara mbi 6-10 sondazhe të ndryshme dhe burime të dhënash.

42 <http://info.worldbank.org/governance/wgi/index.aspx#home>

Tabela nr. 8. Eficiencia dhe efikasiteti i qeverisjes, 2015

Shteti	AL	BA	HR	XK*	ME	MK	RS
Treguesi							
Treguesi dhe ranku i percentilit për "efikasitet qeverisës"	0.03 (54.8)	-0.54 (33.65)	0.51 (71.63)	-0.42 (39.42)	0.16 (60.1)	0.13 (58.65)	0.11 (58.17)
Eficiencë qeverisëse (ĖEF) (2016-2017)	3.6 (66)	2.5 (133)	2.4 (136)	-	3.6 (69)	3.7 (60)	2.8 (122)

Burimi: treguesi i "efikasitetit qeverisës" – baza e të dhënave e Bankës Botërore <http://info.worldbank.org/governance/wgi/index.aspx#home>; treguesi i "eficiencës qeverisëse" – baza e të dhënave e Forumit Ekonomik Global <http://reports.weforum.org/global-competitiveness-index/downloads/>

Raporti i Konkurrueshmërisë Globale i Forumit Botëror Ekonomik hedh dritë mbi perceptimet e efikasitetit qeverisës ose mbi performancën e sektorit publik⁴³. Administrata e lartë renditet në një shkallë nga 1-7, shpërdorimi i shpenzimeve qeveritare, barra e rregulloreve qeveritare, efikasiteti i kuadrit ligjor në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve dhe ankimit të kuadrit rregullator si edhe transparenca e qeverisë në hartimin e politikave.

Të dhënat e tabelës nr. 8 tregojnë se në Ballkanin Perëndimor, perceptimet në lidhje me performancën e sektorit publik janë më pak të favorshme sesa në pjesën dërrmuese të vendeve të zhvilluara të BE-së. Sipas këtij treguesi, gjysma e vendeve të Ballkanit Perëndimor janë në mes të listës së vendeve të mbuluara nga sondazhi, me renditje mesatare 3.6 dhe 3.7. Vendet që mbeten janë pothuajse në fund të listës, ku Kroacia renditet në vendin e 136-të, me renditjen më të ulët për sa i takon efikasitetit qeverisës tek 2.4. Renditjen më të lartë nga vendet e Bashkimit Evropian e mbajnë vende si Finlanda, Luksemburgu dhe Suedia, ndërsa sektori publik në Itali ka renditjen më të ulët, në vendin e parafundit (137) nga të gjitha vendet që mbulon sondazhi.

Mungesa e efikasitetit dhe eficiencës së sektorit publik në Ballkanin Perëndimor ul mundësitë për përdorim më të mirë të burimeve, e cila përbën strategjinë kryesore për përmirësimin e shtetit social, në kontekstin e fondeve të kufizuara, situatës së pakë-

43 Në raporte të mëparshme dhe në bazën e të dhënave, ky tregues vjen me emrin "eficiencia në qeverisje", ndërsa në raportin më të fundit vjen e me titullin "performance e sektorit publik". Përkundrazi, peshë që i jepet performancës së sektorit publik është 20% brenda kategorisë së "institucioneve" që është një nga 12 shtyllat mbi bazën e të cilës llogaritet Indeksi i Konkurrueshmërisë Globale (Schwab, 2016, p. 39).

naqshme sociale, cilësisë së dobët të shërbimit, dhe një sërë sfidave të tjera që krijojnë trysni për rritjen e shpenzimeve për sektorin social.

8. Globalizimi dhe integrimi – sfida të mëtejshme për të ardhmen e afërt

Dukuria e globalizimit zakonisht cilësohet si sfidë për shtetet sociale, kryesisht si faktor që kufizon pavarësinë e hartimit të politikave sociale në rang kombëtar. Në kontekstin e shoqërive të zhvilluara evropiane, humbja e pavarësisë kryesisht nënkupton që shtetet sociale "tepër të kushtueshme" nuk mund të jenë konkurruese në rrethanat e globalizimit dhe konkurrueshmërisë me shtete që nuk kanë barrën e taksave të larta dhe përfitime sociale. Kjo tezë është provuar, si në terma teorike, ashtu edhe empirike, me konstatime të ndryshme. Përveç rezultateve që flasin haptazi për "garën drejt fundit" ka edhe fakte për të kundërtën, me argumentin që globalizimi krijon risqe të reja që kërkojnë shtete më të forta sociale, e po ashtu duhet shoqëruar me investime më të larta në sektorin social, si parakusht, ky i fundit për konkurrueshmërinë (Castles, 2004) (Gilbert & Terrell, 2010) (Bar, 2013) (Chen, Görg, Görlich, Molana, & Temouri, 2014).

Në kuadrin e Ballkanit Perëndimor, globalizimi analizohet edhe nga këndvështrimi i influencës së institucioneve ndërkombëtare mbi politikat sociale (Deacon, Lendvai, & Stubbs, 2007); megjithatë, për shumicën e vendeve, një sfidë e veçantë për të ardhmen qëndron tek integrimi evropian dhe anëtarësimi i mundshëm në BE.

Në fazën e "shtetit kandidat" është normale të mos pritet ndonjë ndikim direkt i rëndësishëm në këtë sferë, pavarësisht përmirësimeve të vogla krahasuar me përvojën kroate (Stubbs & Zrinščak, 2005), të cilat reflektohen kryesisht në kërkesën për hartimin e një *Programi të detajtuar për punësimin dhe reformën shoqërore në procesin e anëtarësimit në BE*⁴⁴. Gjithashtu, që nga viti 2015, vendet e Ballkanit Perëndimor hartojnë Programe vjetore për Reformat Ekonomike (ERP), duke u përqendruar ndër të tjera tek tri segmente me rëndësi për shtetin social: arsimi dhe aftësitë profesionale, punësimi dhe tregjet e punës, si edhe përfshirja sociale, ulja e varfërisë dhe mundësitë e barabarta. Megjithatë sipas përfundimeve të Stambolievës në rastin e Serbisë dhe Maqedonisë, "BE-ja nuk arriti të garantonte një influencë të rëndësishme në fushën

44 <http://www.minrzs.gov.rs/cir/dokumenti/pio/item/5782-program-reformi-politike-zaposljavanja-i-socialne-politike-u-procesu-pristupanja-evropskoj-uniji-employment-and-social-reform-programme>



sociale, kryesisht për shkak të përqendrimit në aspekte të tjera (çështja e emrit dhe statusit të Kosovës) çka ngadalësoi hapin e anëtarësimit në BE" (Stambolieva, 2014, p. 290). Sipas Stubbs and Zrinščak, anëtarësimi i Kroacisë në Bashkimin Evropian jo vetëm që nuk arriti të ulte klientelizmin, por madje i hapi më tej mundësitë për thellimin e tij (Stubbs & Zrinščak, 2015, p. 402).

Në vetvete, anëtarësimi i vendeve të Ballkanit Perëndimor në BE, paçka se mbetet ende i pasigurt dhe në një të ardhme të largët, mund të sjellë avantazhe, sikundërse edhe sfida. Integrimi evropian mund të kontribuojë në mënyrë të drejtpërdrejtë në përmirësimin e shteteve sociale të Ballkanit Perëndimor falë trysnive "të lehta" për arritjen e disa standardeve të caktuara në sferën sociale, shkëmbimit të përvojës dhe transferimit të dijeve dhe ideve, vendosjes së kërkesave për miratimin e strategjive dhe raporteve përkatëse për sektorin social, kontributin e ekspertëve në procese të vazhdueshme monitorimi, mundësi të përdorimit të institucioneve arsimore, si edhe akses në fondet sociale evropiane. Ka gjithashtu edhe influenca potenciale të qarta indirekte, kryesisht në fushën ekonomike, si edhe përsa i përket forcimit të rendit dhe fuqizimit të institucioneve demokratike. Megjithatë, sfidat janë potencialisht të rëndësishme gjithashtu, duke nisur që nga shpenzime të tjera që janë në konkurrencë me mbrojtjen sociale (në disa vende, jo vetëm falë anëtarësimit në BE, por edhe atij në NATO), tek krijimi i pritshmërive tepër të larta midis qytetarëve përsa i përket kapaciteteve për përmbushjen e nevojave të ndryshme, vendosjen e përparësive dhe standardeve tepër të larta, deri tek mungesa e kapaciteteve për përdorimin e fondeve evropiane, apo tek përshpejtimi i emigracionit, që mund të kenë një ndikim vecanërisht të lartë mbi shtetet sociale të Ballkanit Perëndimor në të ardhmen. Së fundi, reagimi ndaj këtyre sfidave dhe hartimi i politikave sociale në secilin vend midis globalizimit dhe evropianizimit do të përcaktohet doemos, sic thekson edhe Zrinščak (2006, p. 25), nga trashëgimia historike dhe kapacitetet vendase.



Zgjedhje dhe mundësi strategjike

Sfidat me të cilat përballen shtetet sociale në vendet e Ballkanit Perëndimor janë të theksuara, dhe pjesërisht specifike. Si fillim, pjesa më e madhe e vendeve kanë një PBB shumë të ulët, situatë sociale të pafavorshme, nivele të larta papunësie dhe rezultate të pamjaftueshme në arsim dhe shëndetësi, shoqëruar me qeverisje dhe administratë ineffikase. Disa nga sfidat specifike janë: nivelet e larta të emigracionit, përqindjet e larta të papunësisë afatgjatë, si edhe nivele të larta të ekonomisë informale; në të ardhmen, shtetet sociale parashikohet të preken në veçanti nga ndryshime intensive në strukturën familjare dhe përsheptim të integritit në BE. Fondet për sektorin social janë të ulëta në terma absolute, me parashikime për një farë rritjeje nëse për të gjithë rajonin në tërësi mund të pritët zhvillim ekonomik. Sfidat ekzistuese dhe ato të ardhme, si edhe shtimi i mundshëm i investimeve në sektorin social, me supozimin e rritjes buxhetore krijojnë nevojën për rishikim të zgjedhjeve dhe mundësive të ndryshme strategjike, me qëllim lehtësimin e zhvillimit të shteteve sociale në vendet e Ballkanit Perëndimor.

Në tekstin më poshtë flitet mbi disa prej zgjidhjeve dhe varianteve të mundshme strategjike. Për të pasur një panoramë më realiste "teorike", variantet parashtrihen në mënyrë të thjeshtuar, ndonëse realiteti doemos përfshin një amalgamë politikash që jo domosdoshmërisht janë në përputhje me një drejtim të vetëm strategjik.

1. Shtet i vogël social i përqendruar tek mbrojtja e të varfërve

Një variant i mundshëm strategjik për shtetet sociale të Ballkanit Perëndimor është që ato të përqendrohen (sërisht) tek shpenzime relativisht të ulëta për mbrojtjen sociale, por me një përqindje të lartë të përfitimeve në para "cash" dhe në natyrë, me qëllim mbrojtjen e shtresave më të varfra të popullsisë.

Sipas kriterëve të Bankës Botërore, në kuadrin e BE-së kjo do të nënkuptonte shpenzimet për mbrojtjen sociale, duke përfshirë kujdesin shëndetësor⁴⁵ nën 16% dhe

45 Për qëllimet e kësaj analize, përkufizimi i mbrojtjes sociale është modifikuar disi në krahasim me metodikën e ESSPROS, me dallim kryesor përjashtimin e shpenzimeve për kujdes shëndetësor (Banka Botërore, 2015, fq. 51).

Zgjedhje dhe mundësi strategjike

Dokument reflektimi

SHTETI SOCIAL NË VENDET E BALLKANIT PERËNDIMOR

SFIDA DHE MUNDËSI

mbulimin e popullsisë në kuintilin më të varfër me pagesa sociale jokontributive⁴⁶ mbi 60%. Vendet e këtij grupi përcaktohen si "shtete sociale të vogla të balancuara". Sipas këtij kriteri, Kroacia, i vetmi vend anëtar në BE mes shteteve të Ballkanit Perëndimor është "shtet social i kufizuar" që do të thotë me shpenzime relativisht të ulta për këto qëllime dhe me mbulesë të ulët të shtresës vulnerabël (World Bank, 2015, p. 38).

Përzgjedhja e një **shteti të vogël social** shihet si e përshtatshme për vendet më pak të zhvilluara, në interes të konkurrueshmërisë që sigurohet nga barra e ulët tatimore dhe/ose krijimi i hapësirës buxhetore për shpenzime që nxisin mundësi zhvillimi (si fjalë vjen, investime në infrastrukturë, mjedis dhe kërkim e zhvillim). Në rastin e Ballkanit Perëndimor, në shumicën e vendeve kjo zgjedhje imponohet edhe për shkak të niveleve të larta të deficitit buxhetor dhe raporteve të larta të borxhit përkundrejt PBB-së. Edhe mes shteteve të reja anëtare të BE dominojnë shtete të vogla sociale.

Për pjesën dërrmuese të vendeve të Ballkanit Perëndimor, me përjashtim të Serbisë dhe Kroacisë, kjo zgjedhje nuk është problematike në kuptimin teknik, duke pasur parasysh nivelet relativisht të ulëta të shpenzimeve në sektorin publik social. Sfida për Bosnje-Hercegovinën qëndron kryesisht në strukturën jofunksionale, tepër të decentralizuar, që për shkak të vetë natyrës së saj kërkon shpenzime të larta.

Fokusi më i lartë i shteteve sociale tek të varfrit ngre një sërë aspektesh të vështira politike, si edhe zgjedhje përmbajtësore. Lindin dy lloj çështjesh për diskutim dhe analizë. Së pari, cilat janë përfitimet që duhet të futen apo zgjerohen në secilin prej vendeve për të garantuar mbrojtje më të madhe për të varfrit (asistencë sociale, strehim social për më të varfrit, shërbime falas për personat e varfër me aftësi të kufizuara, shërbime afatgjata falas për të moshuarit e varfër, shërbime të kujdesit social për familjet më vulnerabël, bursa për studentët nga familje të varfra, përfitime nga fatura e energjisë elektrike për klientët e varfër, shërbime juridike, pensione për të moshuarit e varfër që nuk mbulohen nga sigurimet, investime për të mbështetur romët që jetojnë nën standardet e jetesës së popullatës, në fushën e arsimit dhe kujdesit shëndetësor etj.). Në këtë kuadër është gjithashtu e rëndësishme të konsiderohet hartimi i programeve shitesë dhe ndikimi i tyre për rritjen e shpenzimeve buxhetore për sektorin social. Së dyti, një grup edhe më kompleks çështjesh ka të bëjë me kalimin nga përfitimet kategorike tek ato të targetuara/shënjestruara dhe uljen e shpenzimeve për pagesat nga skema e pensioneve. Në këtë aspekt, disa nga problemet që spikasin në një numër vendesh të Ballkanit Perëndimor përfshijnë përfitimet për veteranët e luftës me aftësi të kufizuara (Bosnje-Hercegovina, Kroacia) dhe shpenzime për pensionet (Serbia). Në Maqedoni dhe

46 Programet e ndihmës ekonomike, sipas terminologjisë së Bankës Botërore.



Malin e Zi, në këtë kategori do të përfshiheshin përfitimet që marrin nënat për lindjen e fëmijëve të dytë e më tej.

Në periudhën afatgjatë, në vendet ku shteti social është relativisht i madh, përzgjedhja e këtij varianti do të kërkonte rritjen e raportit të shpenzimeve të sektorit social gjatë një periudhe të caktuar, duke ndryshuar strukturën e tyre drejt një mbrojtjeje më të madhe për të varfrit. Në vendet me shtet më të vogël social, rritja e PBB-së do të rezultonte në hapësira më të mëdha buxhetore për sektorin social, që nga ana e tij do të përdoret për zgjerimin e përfitimeve të cilat kushtëzohen nga testi i pasurisë apo të cilat përqendrohen kryesisht tek popullata më vulnerabël..

2. Përfitimet universale

Zgjedhja strategjike për ofrim të përfitimeve dhe shërbimeve universale në sektorin social përfaqëson një alternativë ndaj një shtetit të vogël social të përqendruar kryesisht tek të varfrit. Në formën e tij "të pastër", ky variant thelbësisht çon në krijimin e një regjimi demokratiko-shoqëror (Esping-Andersen G., The Three Worlds of Welfare Capitalism, 1990) dhe sigurisht nuk përbën një shtet të vogël social.

Në rastin e vendeve të Ballkanit Perëndimor, rritja e pranisë së përfitimeve universale dhe shërbimeve, pavarësisht nga statusi material apo tregut të punës së përfituesit do të përfshinte kujdes universal shëndetësor dhe arsimor, pagesat për fëmijët pa testim të burimeve, mbulimin e të gjithë të moshuarve nga sistemi i pensioneve, përfitime në para "cash" për të gjithë fëmijët dhe personat me aftësi të kufizuar, akses universal dhe falas për shërbimet e kujdesit social, shërbime kujdesi për fëmijët dhe zhvillimin e fëmijërisë së hershme etj.

Avantazhet e programeve universale përkundrejt atyre të shënjestruara (targetuara) zakonisht mbështeten nga argumente për një mbrojtje më gjithëpërfshirëse të të varfërve për shkak të eliminimit të gabimit të përjashtimit, rezistenca e elektoratit për të pranuar vetëm përfitime të shënjestruara, mungesa e stigmës dhe kundërnxitësit për të punuar, ndërsa për disa përfitime dhe shërbime sociale, prania e efekteve të jashtme është në veçanti e rëndësishme (zakonisht tek arsimi, por edhe në disa pjesë të kujdesit shëndetësor (Gilbert, Transformation of the Welfare State: The Silent Surrender of Public Responsibility, 2002) (Mkandawire, 2005) (Barr, 2012). Së fundi, kostot administrative janë më të ulëta në zbatimin e përfitimeve universale, sikundër janë edhe kostot për përfituesit. Përtej kornizave ideologjike, kundërshtimi kryesor në

Zgjedhje dhe mundësi strategjike

Dokument reflektimi

SHTETI SOCIAL NË VENDET E BALLKANIT PERËNDIMOR

SFIDA DHE MUNDËSI

lidhje me universalizmin është barra e lartë e shpenzimeve, si edhe mungesa e efikasitetit të këtyre programeve përkundrejt uljes së varfërisë, duke pasur parasysh që fonde shumë të mëdha shpenzohen për jo të varfërit për parandalimin e gabimit të përjashtimit dhe për të garantuar mbrojtjen e më të varfërve.

Në kontekstin e dhënë është thelbësore të theksohet se koncepti i përfitimeve universale duhet të dallohet nga mbrojtja universale sociale, një koncept i kohëve të fundit ky që është nxitur si nga Banka Botërore, ashtu edhe nga ILO. Pas kërkesës për arsim fillor universal (një nga Objektivat e Zhvillimit të Mijëvjeçarit 2000) dhe mbulesë universale shëndetësore (Banka Botërore dhe Organizata Botërore e Shëndetësisë në vitin 2013), deklarata e përbashkët e ILO-s dhe Bankës Botërore⁴⁷ e vitit 2015 kërkonte mbrojtje universale sociale gjatë gjithë ciklit të jetës. Kjo iniciativë nënkupton që cilido që ka nevojë për mbrojtje sociale duhet të ketë akses ndaj përfitimeve të ndryshme në para "cash" dhe në natyrë, në veçanti të varfrit dhe personat vulnerabël, pa paragjykuar dizenjon e programit apo praninë/mungesën e targetimit.

Për shkak të shpenzimeve të larta dhe kufizimeve të vendosura nga niveli i ulët i PBB-së dhe niveli i lartë i borxhit dhe deficitit dhe në disa vende shpenzime relativisht të larta të sektori social në rrethana të një barre substanciale tatimore, ky variant, në përgjithësi, mund të konsiderohet vetëm si një zgjedhje e mundshme strategjike afatgjatë.

Nga këndvështrimi hulumtues, një çështje e rëndësishme mbetet nëse zbatimi i disa elementeve të caktuara të aksesit universal në rajonin e vendeve të Ballkanit Perëndimor do të ishte i justifikueshëm në të ardhmen e afërt. Kjo ka të bëjë kryesisht me përshtatshmërinë e kalimit drejt kujdesit shëndetësor universal të financuar nga buxheti publik, në kuadrin e një tregu pune gjithmonë e më fleksibël, ekonomisë së përhapur informale dhe problemeve të tjera që rezultojnë në mbulesë të paplotë (të popullatës rome, punonjësve të ndërmarrjeve që nuk paguajnë sigurime shoqërore, apo të moshuarit që nuk mbulohen as nga sigurimet e skemës së pensioneve, as nga programet e asistencës sociale). Për më tepër, hulumtimet në lidhje me ndikimin e aftësisë së kufizuar mbi standardin e jetesës mund të hedhin dritë për pranimin e mundshëm të p.sh. pagesave universale për fëmijët dhe/ose shërbime sociale falas për fëmijët me aftësi të kufizuara të rënda. Përfitues të disa prej këtyre pagesave dhe shërbimeve universale mund të ishin edhe romët që jetojnë në kushte jashtë standardit të jetesës. Aspekti i përfitimeve universale ngrihet gjithashtu edhe në kontekstin e zhvillimit të hershëm të fëmijës, duke pasur parasysh rëndësinë gjithmonë në rritje të këtij faktori për rezultate më të mira arsimore dhe ndikimin e tij në uljen e varfërisë.

Një parakusht thelbësor lidhur me vendimmarrjen në lidhje me të gjitha masat që përmban ky variant është vlerësimi i kostove dhe krijimi i hapësirës buxhetore. Akses

47 http://www.ilo.org/global/topics/social-security/WCMS_378991/lang--en/index.htm



universal mund të pranohet vetëm nëse sigurohen më shumë fonde për sektorin social, si rezultat i rritjes së PBB-së, ose në rast se krijohet hapësira buxhetore përmes rristurimit (ulja ose heqja e disa përfitimeve të caktuara) dhe rritjes së efikasitetit.

3. Shteti i investimit social

Zgjedhja strategjike për zhvillimin e një shteti të investimit social praktikisht nënkupton dhënien përparësi disa investimeve dhe reformave si pasojë e rëndësisë së tyre për zhvillimin njerëzor dhe rritjen ekonomike. Në këndvështrimin e Komisionit Evropian kjo zgjedhje ka të bëjë me modernizimin e shtetit social⁴⁸.

Shteti i investimit social nënkupton përqendrimin tek rritja e efikasitetit, si edhe investime shtesë në arsim dhe shëndetësi, kujdes për fëmijët dhe zhvillimin e fëmijërisë së hershme, shërbime punësimi, politika aktive të tregut të punës dhe programe rehabilitimi dhe trainimi.

Për vendet e Ballkanit Perëndimor, me nivele tepër të ulëta investimesh në arsim dhe/ose shëndetësi, shoqëruar me rezultate tejet të pafavorshme, siç është rasti i Shqipërisë, fokusi tek investimet sociale do të thoshte që në të ardhmen shteti social duhet të përqendrohet kryesisht tek zhvillimi i pikërisht këtyre segmenteve të sektorit social. E njëjta gjë mund të thuhet për rezultatet tejet të paavorshme në Kosovë dhe Maqedoni, si edhe për treguesit e pafavorshëm shëndetësorë, në veçanti përqindjet e larta të vdekshmërisë foshnjore (Tabela nr. 6). Si një paradoks, dhe pjesë e politikës së popullsisë, një numër vendesh të Ballkanit Perëndimor japin fonde relativisht të mëdha për inkurajimin e shtimit të numrit të lindjeve, ndërkohë që nuk bëjnë përpjekje të mjaftueshme për zhvillimin e programeve të fëmijërisë së hershme apo programe të kujdesit përpara dhe pas lindjes, me synim uljen e vdekshmërisë së fëmijëve të lindur.

Prioritizimi i reformave në arsim dhe zhvillimi i aftësive profesionale, sipas disa hulumtuesve është kushti kryesor i rritjes ekonomike në vendet e rajonit të Ballkanit Perëndimor (Arandarenko & Bartlett, 2012, p. 4). Në sfondin e arsimit, ka disa nevoja dhe prioritete të dallueshme. Mungesa e njohjes së rëndësisë së zhvillimit të fëmijërisë së hershme dhe dallimit midis këtij funksioni dhe kujdesit për fëmijët në shumicën e

48 <http://ec.europa.eu/social/main.jsp?langId=en&catId=1044&newsId=1807&furtherNews=yes>

Zgjedhje dhe mundësi strategjike

Dokument reflektimi

SHTETI SOCIAL NË VENDET E BALLKANIT PERËNDIMOR

SFIDA DHE MUNDËSI

vendeve të Ballkanit Perëndimor është një tematikë e rëndësishme për investimet shoqërore⁴⁹.

Sigurisht, një shtet i investimit social do të kërkonte përmbushjen e disa nevojave konkurruese me njëra-tjetrën, në kontekstin e buxheteve tejet të kufizuara. Ndaj, rrjedhimisht, çështja kryesore është cilat janë prioritetet e "paketës së investimeve" për cdo vend të Ballkanit Perëndimor në veçanti, cilat janë shpenzimet shtesë, si të krijohet hapësira buxhetore për investime të mëtejshme. Duke pasur parasysh nivelin e lartë të papunësisë, politikat për zhvillimin e veprimtarisë ekonomike nuk janë prioritet në vendet e Ballkanit Perëndimor në të njëjtën shkallë si në vendet me mungesa në krahun e punës. Po ashtu, në vendet ku ende ekzistojnë familjet tradicionale, futja dhe zgjerimi i shërbimeve për balancimin e punës me jetën familjare nuk përbën prioritet afatshkurtër.

Në këtë kontekst, është e rëndësishme të vlerësohet deri në çfarë shkalle seti i politikave të "investimeve" konsiderohet i përshtatshëm për të luftuar varfërinë. Praktikisht, zgjedhja e kësaj qasjeje mund t'i nxisë shtetet të investojnë më shumë në segmentet e sektorit social që jo domosdoshmërisht shënjestrojnë të varfrit (lejelindje, kujdes për fëmijët, arsim i lartë, politika aktive të tregut të punës që nuk u ofrohen disa grupeve specifike vulnerabël – si p.sh fermerëve tradicionalë) dhe sipas disa hulumtuesve, kalmi nga shteti social tradicional rishpërndarës në shtet social të përqëndruar tek investimet, së paku pjesërisht është përgjegjës për tendencat zhgënjyese për uljen e varfërisë (relative) (Cantillon, 2011, p. 15).

4. Shtet social parandalues

Zgjedhja për zhvillimin e një shteti social parandalues do të nënkuptonte përqendrimin tek ato masa dhe politika që parandalojnë risqet dhe lehtësojnë nevojat për ndërhyrje për uljen e varfërisë. Historikisht i është kushtuar shumë më shumë vëmendje përballimit të risqeve të ndodhura, sesa parandalimit apo zbutjes së tyre (Holzmann, Sherburne-Benz, & Tesliuc, 2003, p. 9).

49 Nuk është kuptuar sa duhet se këto dy funksione të ndryshme, që kanë dy synime të ndryshme (arsimi përkundrejt pajtimit punë-familje), dhe rrjedhimisht grupe të ndryshme të synuara (fëmijët nga familje me problem sociale përkundrejt fëmijëve prindërit e të cilëve punojnë, nga familje më në gjendje). Problem thellohet edhe më tej nga fakti se zhvillimi i fëmijërisë së hershme dhe kujdesi për fëmijën zakonisht financohen nga buxhete të kufizuara lokale dhe nuk ka ndërgjegjësim të mjaftueshëm që vetëm njëri nga këto funksione detyrimisht përfshin shërbimin relativisht të kushtueshëm të kujdesit gjatë ditës cdo ditë.



Sigurisht, një pjesë e madhe e parandalimit qëndron jashtë mandatit strikt të shtetit social, kryesisht në politikat ekonomike dhe ato të punësimi. Në disa vende, masat më të rëndësishme kanë synuar parandalimin e katastrofave (duke përfshirë thatësitë dhe përmbytjet), të aksidenteve (p.sh. aksidentet rrugore), si edhe politikat e antidiskriminimit, masat për mundësi kreditimi për të varfrit, etj.

Në kontekstin e vetë shtetit social, qasja parandaluese nënkupton theksin kryesor tek arsimi dhe përmirësimi i aftësive profesionale, politikat e tregut të punës, politikat e shëndetit publik, kujdesi parësor dhe parandalues shëndetësor, shërbime sociale parandaluese, krijimi dhe zhvillimi i mekanizmave të kontrollit, si p.sh. inspektoriatet për parandalimin e dëmtimeve në punë, etj. Sipas kësaj qasjeje, një tipar tjetër dallues janë një grup masash indirekte të cilat disa hulumtues i quajnë masa parashpërndarëse (përkundrejt rishpërndarjes), që do të krijojnë një shpërndarje më të barabartë të të ardhurave nga tregu (Hall, 2015, p. 257) (Hacker, 2011, p. 35) (Smeeding, 2004, p. 19). Ky grup masash përfshin përcaktimin e një page të lartë minimale, forcimin e dialogut social dhe sindikalizmit për rritjen e pagës, si edhe vendosjen e kërkesave për kompanitë private për të siguruar pensione më të mira dhe më bujare, kujdes shëndetësor, trajnim etj, me qëllim ngushtimin e rolit të shtetit dhe sektorit publik në sigurimin e mbrojtjes sociale. Së fundi, në një kuptim më të gjerë, sigurimet shoqërore luajnë një rol të rëndësishëm në parandalimin e varfërisë në rastin e ndodhjes së risqeve të caktuara.

Në kuadrin e vendeve të Ballkanit Perëndimor, dy çështje kërkojnë vëmendje të posaçme: vendi dhe roli i sigurimeve shoqërore, veçanërisht për pensionin dhe politikat për parandalimin e pabarazisë.

Skemat e sigurimeve shoqërore parandalojnë rënien e nivelit të të ardhurave dhe përqendrimin e standardit të jetesës për shkak të moshës, aftësisë së kufizuar, vdekjes së kryefamiljarit, sëmundjeve, sëmundjeve profesionale dhe papunësisë. Për shumicën e vendeve të Ballkanit Perëndimor, vendi dhe roli i skemës së sigurimeve shoqërore të tipit të Bismarkut, sipas të cilit përfitimet lidhen me pagesën e kontributeve dhe statusin në tregun formal të punës del si një çështje e mprehtë. Kjo ndodh kryesisht pasi sigurimet shoqërore nuk garantojnë sigurinë dhe nuk parandalojnë varfërinë në moshë të madhe për të gjithë popullatën, sidomos kur marrim parasysh përqindjen e lartë të ekonomisë informale dhe papunësisë afatgjatë të lartë. Në këto kushte, është shumë e vështirë të gjesh një zgjidhje të përshtatshme për skemat e sigurimit të pensioneve në vende ku plakja e popullatës është e theksuar, ku ka numër të madh pensionistësh dhe një barrë (relativisht) të lartë të faturës së pensioneve (Serbia, Kroacia). Çdo përpjekje për riprojektimin e sistemit të pensioneve drejt futjes së sigurimeve private të



detyrueshme (shtylla e dytë, sipas terminologjisë së Bankës Botërore) apo reduktimi i skemës publike të pensioneve (shtylla e parë) detyrimisht përballet me kosto të mëdha tranzicioni dhe/ose rritjen e varfërisë tek të moshuarit. Nga këndvështrimi i financimit, këto çështje bëhen edhe më serioze në kontekstin e tendencave për uljen e taksave dhe kontributeve që përbëjnë barrë për koston e punës, duke ngritur nga ana tjetër taksat që nuk dëmtojnë rritjen ekonomike (taksat mbi konsumin, pronën, mbrojtjen e mjedisit) (Mathé, Nicodème, & Ruà, 2015). Fakti që një pjesë e popullatës nuk mbulohet nga sistemi i pensioneve nxjerr në pah nevojën për rregullime të caktuara si p.sh. pensionet sociale apo zgjerimin e skemës së sigurimeve shoqërore për të përfshirë personat që punojnë në sektorin informal⁵⁰.

Gjetja e variantit të "parandalimit të pabarazisë" për vendet e Ballkanit Perëndimor ngre edhe një sërë dilemash. Së pari, a ka hapësirë për ngritjen e pagës minimale, duke pasur parasysh kërkesat për konkurrueshmëri, ndikimin potencialisht negativ për punësimin dhe në veçanti raportet e tyre aktualisht të larta krahasuar me pagën mesatare në të gjitha vendet e tjera, me përjashtim të Malit të Zi (Kovtun, Meyer Cirkel, Murgasova, Smith, & Tambunlertchai, 2014, p. 15). Ndoshta në vend të rritjes së nivelit të tyre, mund t'ia vlen të shumë të merrej në konsideratë deri në ç'masë paga minimale është vërtet e detyrueshme dhe nëse duhet të përcaktohen mekanizma rregullatore apo kontrolli më të sakta për të garantuar përputhshmërinë (Arandarenko, 2011, p. 39). Së dyti, dialogu social dhe rëndësia e sindikatave për vendosjen e pagave të përshtatshme bazuar në treg ngrenë nevojën e një analize të efikasitetit të tyre, mundësisë për influencimin e niveleve të pagave, si edhe ndikimin e mundshëm tek papunësia sipas këtij skenari. Së treti, nevojiten gjithashtu vlerësime të hollësishme të përshtatshmërisë së kalimit të kostove tek punëdhënësit e sektorit privat, duke pasur parasysh kërkesat e imponuara nga nevoja për nxitjen e konkurrueshmërisë. Së fundmi, fakti që ky segment masash parandaluese siguron mbrojtje vetëm për personat e punësuar në ekonominë formale nuk duhet anashkaluar.

5. Përmirësimi i efikasitetit

Duke pasur parasysh morinë e nevojave dhe trysnive që rrisin shpenzimet dhe hapësirën thuajse inekzistente për rritje të ndjeshme të taksave, rritja e efikasitetit është një pjesë thelbësore e reagimit ndaj sfidave me të cilat përballen shtetet sociale.

50 Për më shumë informacion për sigurimet shoqërore dhe zgjerimin e tyre për të përfshirë sektorin joformal, shih shembujt nga Kroacia, Austria dhe Suedia <https://www.seejobsgateway.net>



Përmirësimi i efikasitetit nuk është alternativë, por më shumë një strategji e rëndësishme shoqëruuese, pavarësisht nga variantet e konsideruara më lart. Përmirësimi i efikasitetit është gjithashtu parakusht për ndjekjen e secilës prej zgjedhjeve të diskutuara më lart, duke qenë se ndihmon në krijimin e hapësirës buxhetore për zhvendosjen e fokusit të shtetit social.

Përmirësimi i efikasitetit teknik nënkutpon jo vetëm uljen e shpenzimeve (të kota), por edhe ofrimin e shërbimeve më të mira nga inpute të caktuara. Në përputhje me kërkesën për "efikasitet në miks të produkteve", përmirësimi i efikasitetit mund të nënkuptojë gjithashtu ndryshim të strukturës së shpenzimeve brenda shtetit social si i tërë (p.sh. më pak për transfertat sociale, më shumë për arsimin) ose brenda çdo sektori individual (më pak për arsimin e lartë, më shumë për arsimin fillor dhe zhvillimin e hershëm të fëmijës).

Efikasiteti vlerësohet kundrejt objektivave, si për shtetin social në tërësi, ashtu edhe për sektorë, masa dhe politika individuale. Kështu, p.sh. nëse objektivi kryesor i shtetit social është ulja e rrëzikut të varfërisë, atëherë efikasiteti vlerësohet me anë të krahasimit të shpenzimeve për transfertat sociale dhe përqindjeve të varfërisë relative përpara dhe pas transfertave (European Commission, 2016, p. 7).

Matja e efikasitetit të sektorit social është një sfidë madhore për shkak se rezultatet maten me shumë vështirësi, dhe ndikohen edhe nga një sërë faktorësh të tjerë (zhvillimi ekonomik, punësimi, preferencat, dhe zakonet e doket etj.), ndërsa inputet (të shprehura në terma të shpenzimeve për përfitime individuale sociale) shpesh drejtohen drejt arritjes së synimeve të shumëfishta. Masa dhe politika individuale pothuajse gjithmonë kanë objektiva të shumëfishta. Në kuadrin e këtyre vështirësive lindin propozime për vlerësimin e eficiencës përmes vendosjes së standardeve për inpute, rezultate dhe faktorë kontekstualë (Social Protection Committee and the European Commission Services, 2015, p. 51)⁵¹.

Pavarësisht vështirësive në matje, përpjekjet për përmirësimin e efikasitetit mbeten një aspekt kryesor për ndryshimet dhe reformat në sektorin social, duke përfshirë edhe vendet e Ballkanit Perëndimor. Pjesa më e madhe e vendeve kanë zbatuar apo janë duke zbatuar reforma të shumta për përmirësimin e efikasitetit, ndonëse me efekte, metoda dhe mekanizma që ndryshojnë shumë nga njëri-tjetri për arritjen e asaj që kanë në fokus.

51 Në katër fusha politikash (pensione, papunësi, familje/fëmijë dhe përjashtim social/strehim) janë evidentuar treguesit kryesorë dhe objektivat e referuar nga këta tregues; pas kësaj janë përpiluar disa grafike që bëjnë të mundur hulumtime midis hendekut dhe dallimeve në vende të ndryshme.



Zgjedhje dhe mundësi strategjike

Dokument reflektimi

SHTETI SOCIAL NË VENDET E BALLKANIT PERËNDIMOR

SFIDA DHE MUNDËSI

Në këtë kontekst, është thelbësore që secili vend të identifikojë segmentet e sektorit social ku inputet janë tepër të lidhura me rezultatet; njëkohësisht, në varësi të zgjedhjeve strategjike dhe objektivave parësore lind aspekti i burimeve kryesore të përmirësimit të eficiencës (tkurrja dhe ulja e shpenzimeve apo përmirësimi i rezultateve të arritura me këto shpenzime, ristrukturimi i shtetit social në tërësi dhe brenda secilit sektor etj.). Kjo merr rëndësi të posaçme po të supozohet se rritja e PBB-së sjell hapësirë më të madhe për më shumë investime në sektorin social.

Për shkak të disa karakteristikave të ngjashme që deri në një farë mase janë të përbashkëta ndër shtetet sociale të Ballkanit Perëndimor, gjetja e përgjigjeve të përbashkëta përmes hulumtimit dhe *peer review* të metodave dhe mekanizmave për përmirësimin e efikasitetit del si një objektiv i rëndësishëm. Lista e temave të mundshme përfshin një sërë aspektesh: decentralizimi (çfarë duhet të decentralizohet plotësisht në nivele më të ulëta të qeverisjes dhe çfarë duhet të qëndrojë brenda mandatit kombëtar), ndryshimi në modalitetet e financimit të ofruesve të shërbimeve arsimore dhe shëndetësore (nëse prezantimi i grantit për frymë për shkollat, pagesës për frymë për mjekët në kujdesin parësor apo grupet sipas diagnozave në kujdesin shëndetësor dytësor janë reformat e duhura), aktivizimi i përfituesve të pagesave (në çfarë kushtesh, nëse mund të zbatohen subvencionet për punëdhënësit, përvojat me përfshirjen e përfituesve në shërbime komunitare, përfitime shtesë për të mbuluar kostot e transportit dhe të kujdesit për fëmijët, etj.), përdorimi i teknologjisë së informacionit (sistemet e informacionit për përfitimet në para dhe në natyrë dhe lidhja e tyre me regjistra të tjerë), lufta kundër korrupsionit (në cilat segmente është më i përhapur, çfarë masash janë marrë, cilat metoda kanë dhënë rezultate pozitive), lidhjet ndërsektoriale (hartimi i protokolleve, financim i përbashkët, organe të posaçme ndër-sektoriale), përfshirja e ofruesve jopublikë të shërbimeve (në cilët sektorë kontribuon kjo për rritjen e efikasitetit, cilat janë parakushtet, aspekte të prokurimit publik), zhvendosja/kalimi i kostove tek përfituesit (nivelet e bashkëpagesave në shërbimet shëndetësore dhe ato të kujdesit social, financim i arsimit të lartë), politika aktive të tregut të punës (cilat janë provuar të jenë të suksesshme dhe cilat kanë dështuar), ulja e ekonomisë gri dhe arkëtim më i mirë i taksave (me çfarë mjetesh, me mekanizma kontrolli, rregulluese, ndryshime në strukturën tatimore), ndryshime të parametrave, si edhe reforma strukturore të sistemit të pensioneve (përvojat dhe dilemat në lidhje me shtyllën e dytë, zgjidhje në lidhje me pensionet e parakohshme, vlerësimi i aftësisë së kufizuar, pensioni i fermerëve, etj.).



6. Aspekte të tjera që lidhen me zgjedhje dhe variante strategjike

Në hartimin e zgjedhjeve dhe varianteve strategjike vlen të theksohen katër tematika dhe aspekte më të rëndësishme.

Së pari, me qëllim hartimin dhe përqafimin e zgjedhjeve strategjike nevojitet të përcaktohen qartë prioritetet. Vendosija e prioritetëve është e rëndësishme jo vetëm për shkak të kufizimeve financiare, por edhe për shkak të kapaciteteve të pamjaftueshme administrative dhe kërkimore, që janë thelbësore për hartimin dhe zbatimin e ndryshimeve. Aspekte që lidhen me prioritetet përfshijnë disponueshmërinë e të dhënave, hartimin e politikave dhe strategjive mbi bazë të fakteve dhe në veçanti nevoja për vlerësimin dhe monitorimin. Janë nxjerrë shumë mësimë në lidhje me rëndësinë e gjithë këtyre elementeve; disa janë imponuar si pjesë e procesit të integritit evropian, por rrallë janë zbatuar në praktikë.

Aspekti i dytë konsiston në faktin nëse përpjekjet duhet të përqendrohen kryesisht tek përmirësimi i zgjidhjeve ekzistuese, prezantimi i masave dhe instrumenteve të reja apo tek ndryshimi i paradigms⁵². Në varësi të kapaciteteve, si edhe situatës në disa segmente të shtetit social ka gjasa që përqendrimi tek ndërmarrja e reformave të thella, që përfshijnë ndryshim të paradigms të mos jetë gjithmonë efikas, pavarësisht atraktivitetit. Në kushtet e fondeve të kufizuara dhe institucioneve të dobëta ekziston madje edhe dilema se deri në çfarë shkalle zbatimi i njëkohshëm i shumë masave komplekse mund të jetë një zgjidhje e pranueshme, në veçanti nëse duhen investime të mëdha (Šunderić, 2015, p. 133). Faktet tregojnë se ka raste kur janë ndërmarrë një numër "i madh" ndërhyrjesh dhe për to janë investuar përpjekje dhe burime, por janë lënë në mes apo janë braktisur me ndryshimin e qeverive. Këto rezultate lidhen me mungesën e të dhënave të mjaftueshme për ndryshime, si edhe pranimi i rrëmbyer i ndryshimit të imponuar të paradigms, pa konsensus profesional.

Së treti, të gjitha vendet përballen me çështjen e nivelit optimal të decentralizimit, si edhe me zhvillimin e pabarabartë të mbrojtjes sociale, jo e pranishme sa duhet në zonat rurale, vendbanimet nënstandarde dhe shpesh në rajone specifike. Kjo çështje është sidomos e theksuar në vende ku shërbimet e kujdesit social për të moshuarit, fëmijët dhe personat me aftësi të kufizuara varen totalisht nga buxhetet vendore. Zg-

52 Në përputhje me teoritë e ndryshimeve të linjës së parë, dytë dhe të tretë, dmth përmirësimë, ndryshime të instrumenteve individuale, dhe ndryshime themelore të politikave (Hall, 1993).

Zgjedhje dhe mundësi strategjike

Dokument reflektimi

SHTETI SOCIAL NË VENDET E BALLKANIT PERËNDIMOR

SFIDA DHE MUNDËSI

jidhjet e disponueshme nuk arrijnë të garantojnë mbështetje për familjen e gjakut dhe ngadalësojnë procesin e deinstitutionalizimit, i cili mbetet një problem madhor për rajonin. Po të kemi parasysh një koncept më të gjerë, koncepti i decentralizimit gjithashtu përfshin dilemat që lidhen me zhvendosjen e ofrimit të shërbimeve nga sektori publik tek sektori privat dhe joqeveritar.

Në përfundim, *peer review* në nivel konceptual dhe teknik, shkëmbimi i të dhënave, sigurimi i një forumi të përhershëm për diskutime, kërkime dhe hulumtime të përbashkëta, hartimi i treguesve specifikë rajonalë mund të ndihmojnë në kapërcimin e pjesshëm të problemit të kapaciteteve të kufizuara, mund të garantojnë ide më të mira përmes krahasimeve, të shmangin zgjidhjet e papërshtatshme dhe të përqafojnë praktika të shëndosha dhe novatore. Është e rëndësishme të shpallen nisma rajonale, duke pasur parasysh rëndësinë e paktë që i jepet shtetit social në procesin e integritetit evropian, duke rrezikuar që këto çështje të mbeten jashtë vëmendjes së vendimmarrjes.



Referencat

Agencija za statistiku Bosne i Hercegovine. (2016). *Bosna i Hercegovina u brojevima 2016*. Sarajevo: Agencija za statistiku Bosne i Hercegovine.

Agencija za statistiku Bosne i Hercegovine. (2016a). *Demografija 2015*. Sarajevo: Agencija za statistiku Bosne i Hercegovine.

Arandarenko, M. (2011). *Pomoćne strategije za oporavak od krize u jugoistočnoj Evropi Studija procene*. Srbija. Budapest: International Labour Organization.

Arandarenko, M. (2015). *Conference Paper: Creating Jobs for Equity and Prosperity – A sub-regional Conference on Employment and Social Inclusion in South East Europe and Turkey A summary of past and present approaches*. Skopje.

Arandarenko, M., & Bartlett, W. (2012). *Labour Market and Skills in Western Balkans COuntries*. Belgrade: FREN – Foundation for the Advancement of Economics.

Bar, N. (2013). *Ekonomija države blagostanja*. Beograd: Fakultet za ekonomiju, finansije i administraciju.

Baucal, A., & Pavlović Babić, D. (2009). *Kvalitet i pravednost obrazovanja u Srbiji: obrazovne šanse siromašnih*. Beograd: Beograd: Vlada Republike Srbije i Institut za psihologiju.

Beveridge, W. (1942). *Social Insurance and Allied Services*. London: His Majesty's Stationary Office.

BiH Council of Ministers. (2016). *Economic reforme programme 2016–2018 (ERP BiH 2016–2018)*. Sarajevo.

Bobić, M., & Vukelić, J. (2011). Deblokada «druge demografske tranzicije»? *Sociologija*, 53 (2), 149–176.

Briggs, A. (1961). Welfare state in historical perspective. *European Journal of Sociology*, 11 (2), 221–258.

Cantillon, B. (2011, March). The Paradox of the Social Investment State. Growth, Employment and Poverty in the Lisbon Era. *CSB Working Paper* (11).

Castles, F. (2003). The world turned upside down: below replacement fertility, changing preferences and family-friendly public policy in 21 OECD countries. *Journal of European Social Policy*, 13 (3), 209–227.

Castles, F. (2004). *The Future of Welfare State: Crisis Myths and Crisis Realities*. New York: Oxford University Press.

Centralna banka Crne Gore . (2016). *Godišnji makroekonomski izvještaj Centralne banke Crne Gore 2015. godina*. Podgorica: Centralna banka Crne Gore.

Centre for Social and Economic Studies; Development Research Centre on Migration, Globalisation and Poverty, University of Sussex, UK. (2006). *From Brain Drain to Brain Gain: Mobilising Albania's Skilled Diaspora A policy paper for the Government of Albania*. Policy paper, Tirana.

Chen, Y.-F., Görg, H., Görglich, D., Molana, H. M., & Temouri, Y. (2014). Globalisation and the Future of Welfare State. *IZA Policy Paper* (81).

De Bruijn, B., Eelens, F., Schoorl, J., Galanxhi, E., Nesturi, M., & Hoxha, R. (2014). *Population and Population dynamics in Albania new demographic horizons?* INSTAT, Republic of Albania Institute of Statistics.

Deacon, B., Lendvai, N., & Stubbs, P. (2007). Social policy and international interventions in South East Europe: conclusions. In: *Social policy and international interventions in South East Europe* In B. Deacon, & P. Stubbs, (pp. 221-242). Cheltenham: Edward Elgar

Devedžić, M., & Stojiljković Grnjatović, J. (2015). *Popis stanovništva, domaćinstava i stanova 2011. u Republici Srbiji: Demografski profil starog stanovništva Srbije*. Republički zavod za statistiku.

Esping-Andersen, G. (1990). *The Three Worlds of Welfare Capitalism*. Princeton, New Jersey: Princeton University Press.

Esping-Andersen, G. (2006). Kakva socijalna država za XXI. stoljeće? Konvergencije i divergencije europskih država. In S. Z. (ur.), *Socijalna država u 21. stoljeću: Privid ili stvarnost?* (pp. 29-60). Zagreb: Pravni fakultet.

Esping-Andersen, G., & Myles, J. (2011). Economic inequality and welfare state. In W. Salverda, B. Nolan, & T. M. Smeeding, *The Oxford Handbook of Economic Inequality*. Oxford: Oxford University Press.

European Commisison. (2016). *European Semester Thematic Fiche: Poverty and Social Exclusion*.

Evropska komisija. (2015). *Pregled obrazovanja i osposobljavanja za 2015: Hrvatska*. Luxembourg: Ured za publikacije Europske unije.

Garfinkel, I., & Smeeding, T. (2010). Wealth and Welfare States: What Is the Real Story? *Institute for Research on Poverty Discussion Paper no. 1387-10*.

Gedeshi, I., & Jorgoni, E. (2012). *Social Impact of Emigration and Rural-Urban Migration in Central and Eastern Europe: Albania*. On behalf of the European Commission DG Employment, Social Affairs and Inclusion.

Gerovska-Mitev, M. (2015). Poverty and Social Exclusion in Maqedonia, Serbia and Kroaci: Status and Policy Responses. *Revija za socijalnu politiku*, 22 (2), 81-94.

Gilbert, N. (2002). *Transformation of Welfare State: The Silent Surrender of Public Responsibility*. New York : Oxford University Press.

Gilbert, N., & Terell, P. (2010). *Dimensions of social welfare policy*. Boston: Allyn & Bacon.

Glennester, H. (2007). The sustainability of western welfare states. *Paper given at CASE seminar November 2007, London School of Economics and Political Science*.

Gough, I. (2008). European Welfare States: Explanations and Lessons for Developing Countries. In A. A. Dani, *Inclusive states: social policy and structural inequalities* (pp. 39-72). Washington: World Bank Publications.

Government of Albania. (2016). *Albania's Economic Reform Programme 2016 - 2018*. Tirana.

Government of Montenegro. (2017). *Economic Reform Programme for Montenegro 2017-2019*. Podgorica.

Group of experts on Making Work Pay. (2003). *Making work pay: Facts, figures and policy options*, Report to the Employment Committee.

Hacker, J. S. (2011). The institutional foundations of middle-class democracy. In *Priorities for a new political economy: Memos to the Left* (pp. 33-38). London: Policy Netëor.

Hall, P. A. (2015). Postscript: The Future of welfare state. In C. Chwalisz, & P. Diamond, *The Predistribution Agenda: Tackling Inequality and Supporting Sustainable Growth* (pp. 255-265). London: Policy network.

Hemerijck, A. (2012). Two or three waves of welfare state transformation? In N. Morel, B. Palier, & J. (. Palme, *Towards Social Investment Welfare State? Ideas, Policies and Challenges* (pp. 33-61). Bristol: The Policy Press.

- Hemerijck, A. (2012a). When Changing Welfare States and the Eurocrisis Meet. *Sociologica* (1).
- Holzmann, R., Sherburne-Benz, L., & Tesliuc, E. (2003). *Social Risk Management: The World Bank's Approach to Social Protection in a Globalizing World*. Washington, D.C.: World Bank.
- IMF. (2015). *Bosnia and Herzegovina: Selected Issues*. Washington, D.C: International Monetary Fund.
- Indicators Sub-Group of Social Protection Committee. (2015). *Portfolio of EU Social Indicators for the Monitoring of Progress Towards the EU Objectives for Social Protection and Social Inclusion*. Luxembourg: Publications Office of the European Union.
- INSTAT, World Bank. (2013). *Albania: Trends in Poverty 2002-2005-2008-2012*.
- Instituti i Statistikave. (2014). *Albania in Figures 2014*. Tirana: INSTAT.
- Instituti i Statistikave. (2016). *Labour Market 2015*. Tirana: INSTAT.
- Jessop, B. (1993). From Keynesian Welfare to the Schumpeterian Workfare State? Preliminary Remarks on Post-Fordist Political Economy. *Studies in Political Economy* (40).
- Jessop, B. (1999). Narrating the Future of the National Economy and the National State? Remarks On Remapping Regulation and Reinventing Governance. In G. (.) Steinmetz, *STATE/CULTURE: State Formation after the Cultural Turn* (pp. 378-406). Ithaca: Cornell University Press.
- Kosovo Agency of Statistics. (2011). *Kosovo Population and Housing Census 2011 Final Results MAIN DATA*. Prishtina: Kosovo Agency of Statistics.
- Kosovo Agency of Statistics. (2013). *Study on Remittance in Kosovo – 2013*. Prishtina: KAS and UNDP.
- Kovtun, D., Meyer Cirkel, A., Murgasova, Z., Smith, D., & Tambunlertchai, S. (2014). *Boosting Job Growth in Western Balkan Countries*. IMF.
- Kosovo Agency of Statistics. (2014). *The Roma, Ashkali and Egyptian Communities in Kosovo Multiple Indicator Cluster Survey, Summary Report*. Prishtina: The Kosovo Agency of Statistics.
- Lesthaeghe, R. (2014). The second demographic transition: A concise overview of its development. *Inaugural Articles by members of the National Academy of Sciences*.
- Letablier, T., Luci, A., Math, A., & Thévenon, O. (2009). *The costs of raising children and the effectiveness of policies to support parenthood in European countries: a Literature Review*. Brussels: European Commission.
- Lindert, P. H. (2016). Real and Imagined Threats to shtetit social. *Working paper*
- Mathé, M., Nicodème, G., & Ruà, S. (2015). *Tax Shifts*. Luxembourg: Office for Official Publications of the European Communities.
- Matković, G., Mijatović, B., & Stanić, K. (2014). *Novčana davanja za decu i porodice sa decom u Srbiji*. Beograd: UNICEF
- Mijatović, B. (2014). *Siromaštvo u Srbiji 2011, 2012. i 2013. godine*. Centar za liberalno demokratske studije. Beograd: Tim za socijalno uključivanje i smanjenje siromaštva.
- Milanović, B. (2012). *Bogataši i siromasi: Kratka i neobična istorija globalne nejednakosti*. Beograd: Službeni glasnik.
- Ministarstvo regionalnoga razvoja i fondova Evropske Unije. (2017). *Strategija regionalnog razvoja RH za razdoblje do kraja 2020*. Zagreb.

Ministarstvo za ljudska prava i izbjeglice Bosne i Hercegovine i Agencija za statistiku Bosne i Hercegovine. (2013). *Istraživanje višestrukih pokazatelja (MICS) o romskoj populaciji u Bosni i Hercegovini 2011.–2012: završni izvještaj*. Sarajevo: UNICEF.

Mkandawire, T. (2005). Targeting and universalism in poverty reduction. *UNRISD Social Policy and Development Programme Paper* (23).

Morel, N., Palier, B., & Palme, J. (2012). Beyond welfare state as we knew it? In N. Morel, B. Palier, & J. (. Palme, *Towards Social Investment Welfare State? Ideas, Policies and Challenges*. Bristol: The Policy Press.

OECD. (1998). *The Battle against Exclusion: Social Assistance in Australia, Finland, Sweden and the United Kingdom*. Paris: OECD Publishing.

OECD. (2016). *PISA 2015 Results in Focus*. OECD.

Petrović, M. (2011). Promene bračnosti i porodičnih modela u postsocijalističkim zemljama: zakasnela i nepotpuna ili specifična druga demografska tranzicija? *Stanovništvo* (1), 53–78.

Republic of Kosovo. (2016). *Kosovo Economic Reform Programme 2016*. Tirana.

Republic of Macedonia. (2016). *Economic Reform Programme 2016*. Skopje.

Republic of Macedonia. (2015). *National Economic Reform Programme 2015*.

Republički zavod za statistiku Srbije. (2016). *Anketa o radnoj snazi : revidirani podaci za 2014. i 2015. godinu*. Beograd: RZS.

Republički zavod za statistiku i UNICEF. (2015). *Srbija: Istraživanje višestrukih pokazatelja 2014 i Srbija: Romska naselja istraživanje višestrukih pokazatelja 2014 – Praćenje stanja i položaja žena i dece – konačni izveštaj*. Beograd: Republički zavod za statistiku i UNICEF

Schwab, K. (2016). *The Global Competitiveness Report 2016–2017*. Geneva: World Economic Forum.

Schëarz, A. M., Arias, O. S., Zviniene, A., Rudolph, H. P., Eckardt, S., Koettl, J., et al. (2014). *The Inverting Pyramid: Pension Systems Facing Demographic Challenges in Europe and Central Asia*. Washington DC: World Bank.

Smeeding, T. M. (2004). Public policy and economic inequality: The United States in comparative perspective, . *LIS Working Paper Series* (367).

Social Protection Committee and the European Commission Services. (2015). *Social Protection Systems in the EU: Financing Arrangements and the Effectiveness and Efficiency of Reburimi Allocation*. Luxembourg: Publications Office of the European Union.

Stambolieva, M. (2014). *Welfare State Transformation in the Context of Socio-economic and Political Changes A Comparative Analysis of the post-Yugoslav States: Slovenia, Kroaci, Serbia and Maqedonia*. Kassel.

State statistical office of the Republic of Macedonia. (2016). *Labour force survey, 2015*. Skopje: State statistical office of the Republic of Macedonia.

Stiglitz, J. (2013). *Ekonomija javnog sektora*. Beograd: Ekonomski fakultet.

Stubbs, P. (2005). Stretching Concepts Too Far? Multi-Level Governance, Policy Transfer and the Politics of Scale in South East Europe. *Southeast European Politics*, VI (2), pp. 66–87.

Stubbs, P., & Zrinščak, S. (2005). Extended Social Europe? Social Policy, Social Inclusion and Social Dialogue In Kroaci and the European Union . In E. b. Ott, *Kroacin Accession to the European Union: Facing the Challenges of Negotiations*, vol 3 (pp. 161–184). Zagreb: Institute of Public Finance.

Stubbs, P., & Zrinščak, S. (2015). Citizenship and Social Welfare in Croatia: Clientelism and the Limits of 'Europeanisation'. *Journal European Politics and Society*, 16 (3), 395–410.

Svetska banka. (2015). *Jugoistočna Evropa Redovni ekonomski izveštaj br. 8 Rast se oporavlja, rizici rastu*

Šunderić, Ž. (2015). *Uloga institucija u stvaranju socijalne kohezije*. Beograd: Fakultet za ekonomiju, finansije i administraciju.

Tesliuc, E., Pop, L., Grosh, M., & Yemtsov, R. (2014). *Income Support for the Poorest A Review of Experience in Eastern Europe and Central Asia*. Washington DC: World Bank.

UNFPA. (2015). *United Nations Department of Economic and Social Affairs/Population Division World Population Prospects: The 2015 Revision, Key Findings and Advance Tables*. New York: United Nations.

Vlada Crne Gore Zavod za statistiku. (2016). *Anketa o potrošnji domaćinstava u 2015. godini*. Podgorica: MONSTAT

Vlada Republike Srbije. (2016). *Program reformi politike zapošljavanja i socijalne politike u procesu pristupanja Evropskoj Uniji*. Beograd

World Bank. (2011). *Social safety nets in Western Balkans Countries: design, implementation, and performance*. Washington, DC.

World Bank. (2013). *Consumption Poverty in Republic of Kosovo in 2011*. Washington DC: World Bank.

World Bank. (2015). *EU Regular Economic Report No.2: EU regular economic report tēo : sustaining recovery, improving living standards*. Washington DC: World Bank Group.

World Bank. (2016). *Poverty Reduction, Shared Prosperity and Inequality in FYR Magedonia in the post-crisis period (2009–2013)*. Poverty and Equity Global Practice Europe and Central Asia Region. World Bank.

World Bank; Vienna Institute for International Economic Studies. (2017). *Western Balkans: Labor Market Trends 2017*.

Zavod za statistiku Crne Gore. (2013). *Struktura domaćinstava u Crnoj Gori*. Podgorica: MONSTAT.

Zavod za statistiku Crne Gore. (2014). *Istraživanje višestrukih pokazatelja u romskim naseljima 2013, Ključni nalazi*. Podgorica: MONSTAT

Zavod za statistiku Crne Gore. (2014a). *Analiza siromaštva u Crnoj Gori u 2013. godini*. Podgorica: MONSTAT

Zeneli, B., Cosic, E., Dzebo, A., & Zmejkoski, R. (2013). *Brain Gain Policies and Practices in Western Balkans Countries*. Belgrade: Group 484 Centre for Migration.

Zrinščak, S. (2006). *Socijalna politika u procjepima globalizacije i europeizacije*. In S. (. Zrinščak, *Socijalna država u 21. stoljeću: Privid ili stvarnost?* (pp. 1–27). Zagreb: Pravni fakultet.

Žarković-Rakić, J., & al, e. (2017). *Reduction of child poverty in Serbia: Improved cash-transfers or higher work incentives for parents? Partnership for economic policy*.

PERFORM

Performing and Responsive Social Sciences



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC



HELVETAS
Swiss Intercooperation

UNIFR



UNIVERSITÉ DE FRIBOURG
UNIVERSITÄT FREIBURG